



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Zyra e Kryetarit

Datë:	19.03.2026
Referencë:	
Nga:	Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
Për:	Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit Komunal
Lënda:	Raporti vjetor janar – dhjetor 2025 i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale

I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal, z. Daut Azemi,

Me anë të kësaj shkrese po ua dërgoj raportin vjetor janar – dhjetor 2025 të punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.


Ky raport për periudhën e lartcekur paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025 dhe është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Shtojcë:

Raporti i punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale janar – dhjetor 2025

 REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA KOMUNA E LIPJANIT OPŠTINA LIPLJAN					
PRANUAR NË:		20.02.2026			
PRIMJENI DANA:					
NJËSIA JEDINICA	NR. KLASIFIKIMIT OR. KLASIFIKACIJE	NR. LËNDËS SB. PREDMETA	SHTOJCA PRILOG		
01-	052/01-	9133			

KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN



R A P O R T **I PUNËS I ZYRËS SË KRYETARIT DHE** **DREJTORATEVE KOMUNALE** **JANAR – DHJETOR** **2025**

Shkurt, 2026

PËRMBAJTJA

Fjalahyrëse e Kryetarit.....	3
Përmbledhje Ekzekutive.....	4

ZYRA E KRYETARIT

1. Sektori për Përfaqësim dhe Çështje Ligjore	4
2. Avokatja Publike Komunale	5
3. Sektori për Marrëdhënie me Publikun	7
4. Njësia për Auditim të brendshëm	9
5. Sektori i Personelit	11
6. Sektori pronësor – juridik	13
7. Zyra Lokale për Komunitete	14

DREJTORATET KOMUNALE

1. Drejtorati për Administratë.....	15
2. Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	19
3. Drejtorati për Arsim	31
4. Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport	39
5. Drejtorati për Buxhet dhe Financa	41
6. Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim	53
7. Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.....	55
8. Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.....	63
9. Drejtorati për Infrastrukturë	65
10. Drejtorati për Inspeksion.....	67
11. Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari.....	71
12. Drejtorati i Shërbimeve Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.....	73
13. Drejtorati i Prokurimit.....	77

FJALA HYRËSE E KRYETARIT

Të dashur qytetarë të Komunës së Lipjanit,
I nderuar Kryesues i Kuvendit Komunal,
Të nderuar asambleistë, përfaqësues të institucioneve, media dhe të pranishëm,

Me përgjegjësi të plotë institucionale, me krenari qytetare dhe me bindje të thellë politike në vizionin tonë zhvillimor, para jush paraqes Raportin Vjetor të Punës së Ekzekutivit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025.

Viti 2025 ishte vit i vendimeve të mëdha, i projekteve strategjike dhe i veprimit konkret, një vit që e ka shndërruar Lipjanin në një model funksional të qeverisjes lokale në Kosovë. Ky raport nuk është thjesht një pasqyrë shifrash, por dëshmi e qartë e një filozofie qeverisëse që vendos qytetarin në qendër të politikave publike.

Në një kontekst sfidues ekonomik, social dhe institucional, ne kemi zgjedhur rrugën e përgjegjësisë, guximit dhe vendimmarrjes së drejtë, duke dëshmuar se zhvillimi nuk është premtim elektoral, por punë e përditshme, planifikim i mençur dhe menaxhim i ndershëm.

Gjatë vitit 2025 kemi intensifikuar investimet kapitale, kemi forcuar disiplinën buxhetore, kemi avancuar transparencën dhe kemi ndërtuar një administratë më profesionale, më efikase dhe më të afërt me qytetarin. Lipjani sot është një komunë që planifikon, realizon dhe llogaridhënie, duke ndërtuar standarde të reja në qeverisjen lokale.

Projektet infrastrukturore madhore, zgjerimi i shërbimeve shëndetësore, përmirësimi i cilësisë në arsim, mbështetja direkte për bujqësinë, biznesin dhe rininë, si dhe investimet në kulturë, sport dhe digjitalizim, janë dëshmi se Lipjani po ndërton themele të qëndrueshme për zhvillim afatgjatë.

Në veçanti, viti 2025 ka shënuar konsolidimin e projekteve strategjike, të cilat nuk ndikojnë vetëm në përmirësimin e jetës së përditshme, por e pozicionojnë Lipjanin si një qendër të re zhvillimore në rajon.

Qeverisja jonë ka dëshmuar se politika mund dhe duhet të jetë instrument shërbimi, jo privilegji, dhe se besimi i qytetarëve fitohet vetëm me punë, ndershmëri dhe rezultate konkrete.

Të nderuar qytetarë,

Ky raport është një kontratë morale mes nesh dhe jush, një zotim se rruga e nisur nuk ndalet. Me vizion të qartë, me energji të re dhe me besim të palëkundur, do të vazhdojmë ta ndërtojmë Lipjanin si komunë moderne, të zhvilluar dhe me perspektivë të sigurt për gjeneratat që vijnë.

Ju falënderoj për besimin, bashkëpunimin dhe përkrahjen tuaj të vazhdueshme.

Lipjani po ecën përpara, bashkë po e ndërtojmë të ardhmen!

IMRI AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport për periudhen janar – dhjetor 2025, paraqet punën dhe aktivitetet e realizuara nga Kryetari i Komunës dhe qeverisja lokale. Raporti është në përputhje me kërkesat që dalin nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale për raportim të Kryetarit të Komunës në Kuvendin Komunal.

Edhe në këtë periudhë Janar- Dhjetor 2025, angazhim kryesor i Kryetarit të Komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disciplines në punë. Në vazhdim po e paraqesim raportin që përmban informata për punën e Zyrës së Kryetarit dhe të gjitha Drejtorateve dhe zyrave në kuadër të komunës.

ZYRA E KRYETARIT

SEKTORI PËR PËRFAQËSIM DHE ÇËSHTJE LIGJORE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periudhës raportuese Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore ka vazhduar me përcjelljen e zakonshme të Ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve tjera nënligjore të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës si dhe harmonizimin e akteve të Komunës me dispozitat e reja ligjore.

Gjatë tërë kohës kemi dhënë këshilla juridike dhe kemi ndihmuar drejtoratet dhe sektorët e tjerë të komunës edhe në përplimin e akteve apo rregullimin e pjesës hyrëse- bazës ligjore sipas kërkesave të tyre si dhe kemi dhënë opinione të ndryshme rreth nënshkrimit të Memorandumeve apo Marrëveshjeve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

Gjatë periodës raportuese me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform legjislacionit në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

Për lëndët e adresuara Kryetarit të Komunës nga kompetenca e Drejtorateve dhe e Zyrës së Kryetarit është udhëzuar nëpunësi për dorëzimin e shkresave që lëndët ti dërgojë në Drejtoratet përkatëse ndërsa lëndët e Zyrës së Kryetarit te përpunuesit sipas kompetencës.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës janar-dhjetor 2025, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore me kërkesë të Kryetarit ka përgatitur Vendime, Urdhëresa, Shkresa të ndryshme, Marrëveshje, Kontrata, Autorizime, Propozim Rregullore dhe Propozim Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës të cilat i kemi specifikuar në tabelën në vijim:

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore për periodën janar-dhjetor 2025:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendimet	689 vendime gjithsej 578 vendime me karakter individual jo të përgjithshëm ndërsa 111 vendime me karakter të përgjithshëm
2.	Shkresat	308
3.	Pëlqime	1
4.	Kontrata	16
5.	Marrëveshje	583
6.	Propozim Rregullore dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës	21
7.	Autorizime	1

ZYRA E AVOKATURËS PUBLIKE KOMUNALE

Përmbledhje e përgjithshme e raportimit:

Të autorizuarit për përfaqësim ligjor, sipas autorizimeve nga Kryetari i Komunës, përfaqësojnë Komunën e Lipjanit në të gjitha procedurat gjyqësore, si dhe tek përmbartuesit privat sipas dispozitave ligjore në fuqi.
Duke i kryer detyrat e punës sipas kompetencës, paraqesim raportin e punës për periudhën Janar – Dhjetor për vitin 2025.

Përmbledhje statistikore:

Nga vitet paraprake janë bartur për vitin raportues gjithsej 2064 (civile dhe administrative) lëndë që janë ende në punë. Deri më datën 31.12.2025 në **procedurë civile** të ndara sipas viteve dhe statusit aktual kemi tabelën, si vijon;

Statistikat për periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2025.

Sipas lëndëve të pranuar nga zyra për pranimin e lëndëve dhe të regjistruara në regjistrin e lëndëve brenda afatit 1 Janar – 31 Dhjetor 2025, bën këtë raport të punës me sa vijon;

Lëndë të pranuar civile	210
Lëndë të pranuar përmbartimore	1375
Lëndë në procedurë administrative brenda institucionit	17
Seanca gjyqësore të mbajtura	330
Ankesa të ushtruara në Gjykatën e Apelit (civile dhe përmbartimore)	323
Përgjigje në Padi të ushtruara	210
Prapësime në procedurë përmbartimi	37
Padi të ushtruara	2
Lëndë të arkivuara civile (të përfunduara proceduralisht)	744
Lëndë të arkivuara përmbartimore	328

Përshkrimi i natyrës së lëndëve të pranuar

Nga 210 lëndë (padi dhe propozime) të pranuar në vitin 2025;

Orë mbi normë, mësim në fundjavë, punë gjatë grevës dhe pandemisë	78
Kërkesa sipas Kontratës Kolektive të arsimit (ushqim, udhëtim, inflacion etj.)	49
Anulim vendim të KPMSHCK, ndryshim koeficienti	24
Kualifikim, pas Vendimi të Gjykatës Supreme për anulimin e nenit për pagat	17
Shpronësim / caktimi real i vlerës së tregut	8
Vërtetim pronësie	7
Kompensim dëmi në paluajtshmëri	6
Kompensim i mëditjes për punë në komitetet komunale	5
Kompensim mëditje për punën e kryetarit të fshatit/lagjes urbane	2
Anulim i kontratës (pavlefshmëri)	2
Kompensim dëmi në bujqësi	2
Rrezikshmëri në punë (zjarrkufës)	2
Paga jubilarë dhe paga e 13-të për punëtorët e sektorit të shëndetësisë	2
Kompensim i dëmit material dhe jo-material	2
Kompensim dëmi për shkak të diskriminimit në vendin e punës	1
Anulim të vendimit të Kuvendit të Komunës	1
Anulim procesi të përzgjedhjes së përfituesit për shfrytëzimin e pronës komunale	1
Anulim vendimi i AKK-së dhe Zyrës komnale kadastrale	1

Procedura të filluara sipas kërkesës së organeve komunale

- 1 (një) padi për kompensimin e dëmit të shkaktuar (rimbursim) në vlerë prej 10’745.00 €,
- 1 (një) padi për anulimin e Vendimit të MMPHI,
- 1 (një) padi për kompensim dëmi dhe ri-mbursim e viti 2021 është vendosur pjesërisht në favor të Komunës në vlerë prej 75’955.00 €.

Përmbledhje për disa lëndë të vlerës së madhe

Gjatë periudhës raportuese, veçojmë disa **lëndë të cilat janë gjykuar në dobi të palëve** dhe që kanë vlerë të konsiderueshme financiare, e ato janë (pa cekur emrin e palës):

1	C.nr. 1001/20	Kompensim dëmi material dhe jo-material	196’000.00 €
2	CN.nr. 30/23	Caktim real i vlerës së tregut (shpronësim)	136’395.00 €
3	CN.nr. 46/23	Caktim real i vlerës së tregut (shpronësim)	63’594.00 €
4	CN.nr. 69/20	Caktim real i vlerës së tregut (shpronësim)	38’909.43 €
5	CN.nr. 27/23	Caktim real i vlerës së tregut (shpronësim)	26’934.00 €
6	CN.nr. 59/23	Caktim real i vlerës së tregut (shpronësim)	22’440.00 €

Janë gjithsej 323 Aktgjykime ndaj të cilave kemi uhtar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Në dobi të Komunës veçojmë lëndët e vlerës së konsiderushme, si më poshtë

1	C.nr. 364/19	Kompensim i dëmit jo-material	150'000.00 €
2	C.nr. 860/20	Kompensim i dëmit material	24'811.00 €
3	C.nr. 300/17	Kompensim i dëmit material	18'775.00 €
4	V.Ek. 38/19	Pagim borxhi	18'385.00 €
5	C.nr. 465/22	Kompensim dëmi material dhe jo-material	9'990.00 €

Janë gjithsej 235 Aktgjykime të Shkallës së Parë në favor të Komunës, pra ku është refuzuar kërkespadi palëve si konteste për kualifikim pas viti 2023, orët e punës gjatë grevës, kompensime dëmi në vlerën e përafërt prej 364'000.00 €.

Ndërsa në Shkallë të Dytë (Apel) gjatë vitit raportues janë 39 Aktgjykime në favor të Komunës, lëndë që janë apeluar me sukses si p.sh. pagat e 13-ta në sektorin e shëndetësisë, kompensime dëmi dhe kualifikimi pas viti 2023 në vlerën e përafërt prej 392'000.00 €.

Sfidat

Gjatë periudhave raportuese të kaluara por edhe kësaj periudhe, kanë qenë sfida kryesore që edhe kanë paraqitur problem gjatë mbrojtjes ligjore të interesave të Komunës, mungesa e dokumentacioneve nga arkiva dhe mangësia, vështirësitë për gjetjen e dokumenteve arkivore të viteve të paraluftës.

Sfidë tjetër është e Kontratave kolektive të arsimit dhe shëndetësisë në të cilat Komuna nuk është fare nënshkruese e tyre por janë ministritë përkatëse, të cilat nuk kanë menduar fare për gjetjen e mënyrës së ekzekutimit të obligimeve që rrjedhin nga këto kontrata në procedurë administrative në mënyrë që të mos dëmtohet buxheti i komunave në procedurë gjyqësorë dhe të krijohen shpenzime të pa nevojshme.

Sa i përket kompensimit për kualifikim nga lëmia e arsimit, bazë për miratimin e tyre Gjykata kanë gjykuar që është vendimi i QRK-së nr. 01/33 i dt. 29.08.2008 i cili ende është në fuqi pas anulimit të nenit përkatës nga Gjykata kushtetuese dhe se do të paraqiten padi të reja për kompensimin e kualifikimit, nëse nuk shfuqizohet ky Vendim nga Qeveria apo me ligj për paga ky të shfuqizohet ligjërisht.

Ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave kemi ushtruar padi për ri-mbursim për të gjitha pagesat që janë bërë për shkak të kontratave kolektive, por që paditë ende nuk janë shqyrtuar nga Gjykata që tani gati 3 vite.

Dëme të vazhdueshëm financiar i paraqitet Komunës edhe gjatë procedurës së shpronësimit për shkak të mos vlerësimit real të çmimit të tregut nga Departamenti përkatës i Ministrisë së Financave, ku shumica e palëve që atakojnë vendimet lidhur me shumen e caktuar nga Ministria i fitojnë. Rasti i shpronësimit për njërën nga palët për njësitë për ndërtimin e parkut qendror ku MF e ka llogaritur vlerën për shpronësim në shumen prej 84'884.00 € ndërsa eksperti gjyqësor financiar të njëjtën e ka vlerësuar në shumen prej 429'098.33 € apo 405%. Pra vazhdon problemi i mos vlerësimit real dhe si pasoj dëmi financiar i vazhdueshëm për Komunën sepse parashihi mjetet për shpronësim vetëm aq sa i vlerësoni organi përgjegjës i MF-së.

Për shkak se shumë procedura kanë përfunduar në vitin 2024 dhe tani këtë periudhë raportuese, pritët që në muajt e ardhshëm të pranojmë numër të madh të lëndëve përmbartimore për të i ekzekutuar borxhet dhe obligimet nga ato procedura. Deri sa e kemi përfudnuar vitin 2024 me 366 lëndë përmbartimore, viti 2025 mbyllet me 1368 sosh. Edhe pse një pjesë tanimë janë ekzekutuar dhunshëm nga Thesari i Republikës, mbeten ende një numër i madh i tyre si dhe lëndet civile që pritët të humben rrisin edhe më tej numrin e lëndëve për ekzekutim për vitin e ardhshëm

Rekomandime

Zgjidhje institucionale për Kontratat Kolektive Sektoriale

Në bashkëpunim të ngushtë me Qeverinë e Republikës së Kosovës, përkatësisht me Ministrinë e Financave, Ministrinë e

Arsimit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme, të iniciohet një mekanizëm i përhershëm koordinues me qëllim të:

- Gjetjes së një zgjidhjeje ligjore dhe financiare për kërkesat që rrjedhin nga Kontratat Kolektive Sektoriale, duke përcaktuar qartë përgjegjësinë institucionale për ekzekutimin e obligimeve;
- Parandalimit të inicimit të procedurave gjyqësore të reja ndaj komunave dhe shmangies së shpenzimeve shtesë buxhetore (kamata, shpenzime procedurale dhe përmbarimore);
- Rregullimit përfundimtar të statusit juridik dhe administrativ të zjarrfikësve, për shkak të dualitetit dhe përzierjes së kompetencave ndërmjet Agjencisë për Menaxhim Emergjent (AME), Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Komunave, me qëllim të qartësimit të përgjegjësiave financiare dhe punëdhënëse.

SEKTORI PËR MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Raporti vjetor i Sektori për Marrëdhënie me Publikun përmbledh një gamë të gjerë aktiviteteve dhe arritjesh të rëndësishme. Komuna e Lipjanit ka demonstruar një përkushtim të jashtëzakonshëm ndaj transparencës dhe informimit publik, duke siguruar që qytetarët të kenë qasje të plotë në informacion dhe në aktivitetet e komunës, si dhe duke vazhduar të jetë në mesin e komunave të para për nga niveli i transparencës dhe llogaridhënies.

Në ueb-faqen zyrtare të Komunës ka vazhduar publikimi i materialeve të ndryshme, me qëllim që qytetarëve t'u ofrohen të dhënat e nevojshme. Kjo ueb-faqe ka shërbyer si një kanal shtesë dhe transparent informimi, në të cilën janë publikuar të gjitha vendimet, shkresat, njoftimet, rregulloret, raportet e shpenzimeve financiare, kontratat, planifikimi i buxhetit, ndarja e subvencioneve, si dhe shumë materiale të tjera që i janë drejtuar për publikim Sektorit për Komunikim me Publikun.

Gjithashtu, në pjesën e raportit të performancës komunale, Komuna e Lipjanit ka arritur një sukses të jashtëzakonshëm duke marrë 100% të pikëve në transparencë. Ky rezultat tregon përkushtimin e fortë të komunës për të qenë një model në ofrimin e shërbimeve publike dhe në komunikimin efektiv me qytetarët e saj.

Po ashtu edhe gjatë këtij viti me një transparencë të plotë janë zhvilluar punimet e të gjitha seancave të Kuvendit, të cilat janë transmetuar drejtpërdrejtë në kanalin zyrtarë të komunës në Youtube.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periudhës raportuese, Sektori për Marrëdhënie me Publikun ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

Janë përcjellur aktivitetet e Kryetarit të Komunës, ekzekutivit, Kuvendit dhe Komiteteve brenda dhe jashtë komunës dhe janë përgatitur lajme për publikim në faqen zyrtare, rrjetet sociale dhe media të tjera.

- Sipas kërkesave të Drejtorateve dhe sektorëve tjerë, janë publikuar në faqen zyrtare materialet e ofruara për zyrën e informimit;
- Janë publikuar në ueb faqe të gjitha vendimet e kryetarit, Publikimi i raporteve të drejtorëve për gjatë tërë vitit. Po ashtu janë publikuar në ueb faqe njoftime dhe konkurset e shumta të cilat janë dërguar në zyrën për informim;
- Është bërë publikimi i kontratave të prokurimit sipas kërkesës nga Drejtoria e Prokurimit. Janë ofruar informata për gazetarë duke ju referuar kërkesave të tyre si dhe janë pranuar dhe janë shqyrtuar të gjitha kërkesat për qasje në dokumente publike në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
- Rëndësi të veçantë i është kushtuar përditësimit të ueb faqes së komunës duke ofruar informacione të rëndësishme për qytetar, si publikimi i thirrjeve për grande, thirrjet për subvencionim e shumë dokumente të tjera;
- Gjatë periudhës raportuese, janë realizuar konsultime publike të akteve komunale, duke organizuar debate publike për këto akte me qëllim të përfshirjes së qytetarëve dhe palëve të interesuara në procesin vendimmarrës. Pas zhvillimit të debateve publike, janë përgatitur procesverbalet dhe raportet përkatëse, të cilat dokumentojnë diskutimet dhe

konkluzionet e arritura. Këto dokumente janë publikuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar transparencë dhe llogaridhënie për të gjitha vendimet e marra.

- Materiale të ndryshme që i'u janë drejtuar zyrës për komunikim me publikun janë publikuar edhe në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, platformën e konsultimeve publike të qeverisë së Kosovës dhe në gazetatat ditore për të cilat kërkohet me ligj.
- Po ashtu në periudhën e vitit 2025 është menaxhuar kontrata lidhur me shërbimet mediale në komunën e Lipjanit.
- Është vazhduar publikimi i draft Agjendës javore të takimeve të Kryetarit në ueb faqen e Komunës së Lipjanit, duke përfshirë edhe publikimi e buletinit mujor të aktiviteteve të realizuar nga Kryetari dhe ekzekutivi në ueb faqen e Komunës së Lipjanit.

STATISTIKAT

Nr.	Emërtimi	Publikimet
1	Reportazhi vjetor	1
2	Lajme në web	325
3	Përcjellja e aktiviteteve të komunës në teren	125
4	Marrëveshje	28
5	Vendimet e kryetarit	111
6	Raportet e kryetarit	2
7	Kërkesë / qasje në dokumente publike	42
8	Raporti i auditorit	1
9	Raporte për diskutime publike	8
10	Procesverbalet e konsultimeve	8
11	Deklarimi i pasurisë	2025
12	Raporte të drejtorateve	156
13	Kontrata të prokurimit	91 - p.s kontrata-Transporti i nxënësve të shkollave në relacionet vendbanimi (fshat, lagje) shkollë dhe anasjelltas, 17 Lot të publikuar në një kontratë të vetme dhe gjithsej janë 108 kontrata të publikuara
14	Konkurse	62
15	Njoftime	334
16	Thirrjet dhe Ekstraktet e KKS-së	4
17	Buletin	12
18	Draft Agjenda e Kryetarit	48
19	Thirrje për OJQ	23
20	Plane	2
21	Rregullore	1
22	Statute	1
23	Njoftime për debat me qytetarë	8
24	Vendimet e kuvendit	37
25	Materialet e kuvendit	8
26	Procesverbale dhe ftesa nga sektori i kuvendit	18

TAKIME E NDRYSHME

Janë zhvilluar takime të ndryshme kryesisht me përfaqësues të organizatave që monitorojnë punën në Komunën e Lipjanit. Takime kemi pasur edhe me qytetarë të cilët i janë drejtuar zyrës sonë për informata rreth komunës po ashtu ju kemi përgjigjur kërkesave të qytetarëve përmes thirrjeve telefonike në numrin e zyrës së informimit dhe përmes e-mail adresës zyrtare të komunës.

NJËSIA PËR AUDITIM TË BRENDSHËM

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Me aprovimin e ligjit mbi kontrollin dhe menaxhimin financiar me të cilin ishte ndryshuar koha e dorëzimit të planit vjetor të punës në Ministrinë e Financave pas aprovimit nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës , kështu në Muajin Dhjetor të vitit

paraprak është përpiluar Plani Strategjik Trevjeçar 2025-2026 në të cilin janë paraparë Objektivat kryesore për një cikël trevjeçar të Auditimit për të gjitha fushat e Auditimit.

-Pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë të identifikuar ,pas vlerësimit të rrezikut për secilën fushë është bërë renditja e detyrave të punës të cilat janë auditive të rregullta të planifikuara, duke u bazuar në shkallën e rrezikut për fushat e identifikuar në Planin Strategjik dhe kapacitetet ekzistuese të burimeve njerëzore të cilat i ka Njësia e Auditimit të Brendshëm.

-Plani strategjik për vitet 2025-2027 , dhe plani vjetor i punës për vitin 2025 , pas përpilimit të planeve nga udhëheqësi i NJAB-së janë prezantuar për shqyrtim në Komitetin e Auditimit dhe pas miratimit të tyre janë aprovuar nga Kryetari i Komunës dhe janë dërguar edhe në NJQHB-MFT .

-Në përputhje me Planin Strategjik për vitet 2025-2027, është hartuar edhe plani vjetor i punës për vitin 2025.

NJAB ka filluar së impementuari detyrat e parapara me Planin e aprovuar vjetor të Punës që ti kryej Auditimet e planifikuara me planin vjetor të punës për vitin 2025

Me Ligjin e Auditimit të Brendshëm nr. 03/L-128, Komiteti i Auditimit është kompetentë për aprovimin e planeve të Njesisë së auditimit të brendshëm ,dhe raporteve te punës dhe ndërmjetësues në mes të Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe ZKA me qëllim të implementimit të rekomandimeve të dhëna nga Njësia e auditimit të brendshëm.

-Pas raportimit te detyrave të kryera nga NJAB për vitin paraprak në fillim të vitit 2025 , në Komitetin e Auditimit , NJQHAB-në dhe Zyrës së Kryetarit , NJAB në bazë të planifikimi vjetor për vitin 2025, ka filluar të kryej detyrat e planifikuara në përputhje me planin vjetor të punës për vitin në vijim.

Angazhimi i NJAB në vitin 2025, ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2025 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera , pas pranimi të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final , ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001 , me të cilën ka njoftuar edhe ZKA –an lidhur me progresin e zbatimi të rekomandimeve nga NJAB.

-Puna që është kryer gjatë periudhës Janar 2025-Dhjetor 2025, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2025 , kishte planifikuar Auditime të rregullta, 11 detyra për dhënie të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore Komuna e Lipjanit .

-Angazhimi i NJAB në vitin 2025, ka pasur për objektiv realizimin e auditimeve të planifikuara sipas planit të punës të aprovuar për vitin 2025 dhe kryerjen e rishikimeve për auditimet e kryera , pas pranimi të planit të zbatimit të rekomandimeve nga drejtorët e drejtorive ku është kryer auditimi dhe përmbajtjes së orarit për rishikim të cilin NJAB i dërgon me Raportin Final , ndërsa NJAB pas rishikimit ka përgatitur informatë me shkrim së bashku me formularin 4001 , me të cilën ka njoftuar edhe ZKA –an lidhur me progresin e zbatimit të rekomandimeve nga NJAB.

-Puna që është kryer gjatë periudhës **janar 2025-dhjetor 2025**, i referohet pikërisht përmbushjes së objektivave të parapara me këto Plane të cekura më lartë.

Me planin e punës të aprovuar të NJAB-së për vitin 2025 , kishte planifikuar Auditime të rregullta, 11 detyra për dhënie të sigurisë lidhur me funksionimin e kontrollit të brendshëm në Organizatën Buxhetore Komuna e Lipjanit .

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë vitit 2025 NJAB ,ka Finalizuar 11 Raporte të Auditimit të cilat janë kryer në këto entitete:

1. Auditimi i procedurave të prokurimit për Vitin 2 0 2 4 Fushëveprimi : 01.01.2024- 31.12.2024.
2. Auditimi i të Hyrave nga Tatimi në Pronë –DBF ,Fushëveprimi i auditimit ka qenë periudha prej Shkurt 2024 – Janar 2025
3. Auditimi i Të Hyrave në shkollën e mesme profesionale “Adem Gllavica” dhe Çerdhet e Fëmijëve për përudhen prej 01.09.2022 deri 30.03.2025
4. Auditimi i procesit të Hyrave në drejtorinë për Planifikim dhe Urbanizëm, Fushëveprimi i auditimit është periudha prej 01.04.2024 – 31.03.2025
5. Auditimi i Shpenzimeve në Drejtorinë Komunale të Arsimit për periudhën 01.04.2023-31.03.2025
6. Auditimi i zyrës për menaxhimin e burimeve njerëzore për periudhën 01.06.2023-31.05.2025
7. Auditimi i të hyrave të arkëtuara në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, për periudhën 01.07.2023 – 30.06.2025
8. Auditimi i procedurave për menaxhimin e kontratave me rastin e implementimit të projekteve “ në Drejtorinë për Infrastrukturë për periudhën prej 01.06.2024 -01.07.2025

9. Auditimi i Shpenzimeve në Administratën Komunale periudha (01.10.2024 - 30.09.2025)

10. Regjistrimi dhe Menaxhimi i Pasurive Komunale për periudhën 01.11.2024 – 01.11.2025

11. Auditimi i Performancës „Vlerësimi i sistemit të informatave në sektorin e Tatimit në Pronë për vitin 2024-2025 .

Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2025 , NJAB ka monitoruar edhe shkallën e implementimit të rekomandimeve të cilat janë dhënë me rastin e kryerjes së auditimeve të brendshme dhe për të cilat menaxhmenti (zyrtarët përgjegjës të entiteteve ku është kryer auditimi),ka përgatitur planin e veprimit për implementimin e rekomandimeve të NJAB-së

-Në këtë periudhë janë kryer edhe 8 Rishikime të auditimeve sipas orarit të paraparë për rishikim .

Të gjitha raportet finale janë dorëzuar për përgjegjësitë e entiteteve të audituara dhe Zyrës së Kryetarit dhe Komitetit të Auditimit.

NJAB gjatë vitit 2025 , ka kryer edhe rishikimin e shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga Auditori i jashtëm për raportin e PVF për vitin 2021 , dhe këtë rishikim e ka prezantuar në Asamblenë Komunale .

NJAB në fund të vitit 2025 ju ka dërguar planet e zbatimit të gjitha entiteteve të audituara për të marrë informata lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga NJAB , gjatë vitit 2025 , me qëllim të prezantimit sa më të saktë të shkallës së zbatimit të rekomandimeve nga NJAB në Raportin vjetor i cili dërgohet në NJQHAB .

Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:Numri i rekomandimeve të dhëna në 11 raportet e auditimit është gjithsejtë 53 rekomandime

- Numri i rekomandimeve të zbatuara: 27

- Numri i rekomandimeve në proces: 24

- Numri i rekomandimeve të pazbatuara: 2

Në Muajin Dhjetor janë dorëzuar dy Raporte Finale të Auditimit , ndërsa periudha e zbatimit të rekomandimeve për tri raportet e fundit është v

Në fund të vitit është rishikuar progresi i rekomandimeve për të gjitha raportet finale të lëshuara , nga entitetet e audituara kemi marrë përgjigjet lidhur me progresin e arritur në zbatimin e rekomandimeve .

STATISTIKAT

Për vitin 2025 , NJAB ka kryer 11 Auditime të rregullta të planifikuara të cilat ishin paraparë me planin vjetor të punës për vitin 2025, dhe 10 Rishikime të Auditime të kryera më herët nga NJAB me qëllim të monitorimit të progresit lidhur me zbatimin e rekomandimeve të NJAB-së dhe dërgimi informative të shkruara përgjegjëse të entiteteve të audituara dhe menaxhmentit (kryetarit të komunës) lidhur me shkallën e zbatimit të rekomandimeve.

Takime me Zyrën Kombëtare dhe OSBE për planet e zbatimit të rekomandimeve.

TAKIME E NDRYSHME

-Gjatë këtij viti janë mbajtur edhe pesë takime të rregullta me Komitetin e Auditimit ku janë shqyrtuar raportet e punës së NJAB-së për periudhat:

Takimi i parë është mbajtur me komitetin në Muajin Janar 2025 ,për shqyrtimin e raporteve të punës së NJAB-së për periudhën TM4-2025

-Takimi i dytë për raportin për Tremujorin e parë 2025 , (TM1-2025) , takimi është mbajtur në Muajin Prill- 2025

Takimi i tretë me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e dytë(TM2-2025) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Korrik 2025 .

Takimi i katërt me Komitetin e Auditimit për shqyrtimin e Raportit Tremujorin e tretë(TM3-2025) të NJAB-së, është mbajtur në Muajin Tetor 2025 .

Takimi i pestë me Komitetin e Auditimit për aprovimin e planit strategjik të NJAB-së për vitet **2026-2028** dhe planit vjetor punës për vitin **2026** ,është mbajtur në fund të Muajit Dhjetor 2025 , ku është miratuar plani i punës për NJAB-në nga Komiteti i Auditimit dhe është aprovuar nga Kryetari i Komunës .

SEKTORI I PERSONELIT

PËRMBLEDHJA E PËRGHITHSHME E RAPORTIMIT

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore siguron menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore përmes zhvillimit të procedurave, programeve dhe shërbimeve që kontribuojnë në arritjen e qëllimeve të institucionit dhe punonjësve duke bërë balancimin e duhur të nevojave të punonjësve dhe nevojave të institucionit, si dhe ushtron funksionet e kompetencat në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi në fushën e burimeve njerëzore duke siguruar zbatimin e politikave, legjislacionit dhe procedurave për punësimin, dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Komunën e Lipjanit. Udhëheq procesin e planifikimit, rekrutimit, vlerësimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore si dhe menaxhon e mirëmban sistemin e informatave për menaxhimin e burimeve njerëzore të komunës, identifikimin e nevojave për trajnimin, arsimimin dhe avancimin e burimeve njerëzore.

Në kuadër të fushë veprimtarisë së saj dhe në përputhje me kornizat ligjore në fuqi, që përfshinë shërbimin civil dhe atë publik të Komunës së Lipjanit Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore kujdeset për të drejtat dhe detyrimet e zyrtarëve publikë, në pajtim me dispozitat e ligjore në fuqi. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore është angazhuar në kryerjen e punëve me përgjegjësi të plotë në hartimi e vendimeve dhe shkresave brenda fushëveprimit të saj.

Struktura Organizative e Administratës Komunale për vitin 2025

Nr	
1	Numri i përgjithshëm i të punësuarave në administratën Komunale janë 200
2	Numri i të punësuarave meshkuj janë 116
3	Numri i të punësuarave femra janë 84
4	Numri i të punësuarave nga komunitetet pakicë meshkuj janë 5
5	Numri i të punësuarave nga komunitetet pakicë femra janë 2
6	Të punësuarit me nevoja të veçanta meshkuj janë 2
7	Të punësuarit me nevoja të veçanta femra janë 2

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Njësi për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka sistemuar formularët për vlerësimin e rezultateve në punë të zyrtarëve duke i vendosur nëpër dosje fizike dhe elektronike. Siguron zbatimin e procedurave të vlerësimit të rezultateve në punë, pushimet, trajnimet, administron sistemin për vijueshmërinë në punë, procedurat disiplinore, procedurat e ankesave, mbështet dhe organizon punën e Komisionit Disiplinor për nëpunësit e shërbimit publikë dhe Komisionit të Ankesave për nëpunësit e shërbimit publikë, pezullimin e marrëdhënies së punës, transferimin e nëpunësve, përfundimin e marrëdhënies së punës – lirim nga shërbimi civil, vërtetimet, statistikat e të punësuarve etj., në bazë të legjislacionit në fuqi;

STATISTIKAT

Për më shumë, në formë statistikore, gjeni të bashkangjitur një tabelë, pjesë e këtij raporti përmbledhës.

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Raporti 1 vjetor 2025 (janar, shkurt, mars, prill, maj, qershor korrik gusht, shtator, tetor, nëntor, dhjetor)	12
2	Aktëmrim	14
3	Aktëmrim për Zyrtarët Komunal	110
4	Pëlqime për nëshkrimin e Aktëmrimëve	11
5	Vlerësimi i rezultateve në punë për Zyrtarët e administratës komunale	141
6	Konfirmimi për disponueshmëri të mjeteve buxhetor	12
7	Kompletimi i të dhënave të përvojës së punës për Zyrtarët e Administratës Komunale për Ministrin e Financave	156
8	Punimi i kontratave për Praktikant	49
10	Punimi i kontratave për nëpunës teknik dhe mbështetës	6
11	Punimi i përshkrimit të detyrave të punës	99
12	Rifreskimi i të dhënave të zyrtarëve në dosjet personale dhe në SIMBNJ në rregullimin e përvojës së punës dhe të aktëmrimëve të reja	130
13	Punimi i planit të personelit për administratën komunale arsim dhe shëndetësi	3
	SHKRESAT PËR ANTIKORRUPSION	
14	Njoftime për deklarim të pasurisë në APK	10
15	Njoftime për deklarim të dhuratave për zyrtarët publik të Komunës së Lipjanit dhe APK-ën	2
	LISTAT	
16	Punimi i listës për pagesë për sistem të pagave për anëtarët e kuvendit	60
17	Printimi, shpërndarja dhe mbledhja e listave të pagave	97
	PUSHIMET	
18	Pushime mjekësore.	88
19	Pushime vjetore.	316

20	Pushim i Atësisë, vdekja e anetarit te ngushte	4
	FORMULARET PER NDRYSHIME	
21	Punimi i formularëve për ndryshime	68
22	Punimi i formularëve për punëtorët e larguar	10
23	Punimi i formularëve për punëtores të rinj	15
24	Punimi i formularëve për transfer bankar	3
25	Punimi i formularëve për pagesë retroaktive	50
26	Punimi i formularëve për krijimin e llogaris elektronike	11
	VERTETIMET	
27	Vërtetim për kryerjen e praktikës	41
28	Vërtetim për përvojë të punës	30
	VENDIMET	
29	Vendim për pushim ditore për nënat lehonë për mbrojtjen e të Ushqyerit të fëmijës	3
30	Vendim për ndërprerje e marrëdhënies se punës	9
31	Vendime për kryerjen e praktikës	25
32	Vendim për Pushim të Lehonisë	4
33	Vendim për Transferime	6
34	Vendim për emerimin e Drejtorëve të Drejtoratëve	13
35	Vendim për pensionim	7
36	Vendim për lirim nga detyra	4
37	Vendim për formimin e komisionit per ristrukturim	1
38	Vendim për zbatimin e vendimit te KPMShCK-së	3
39	Vendim për përvojë të punës	17
40	Vendim për kthim të punëtorit në vendin e punës	2
41	Vendime për Udhëtime Zyrtare	12
42	Vendim për shfuqizim të marrëveshjes për punë shtesë	1
43	Vendim për Komisionin për Klasifikimin e vendeve të punës	1
44		
45	Marrveshje për vëllim të shtuar të punës	3
46	Vendim për ushtrues detyre	2
47	Vendim për lirim nga detyra	4
	KONKURSET	
48	Kërkesa për aprovim të konkurseve	23
49	Kontrate për praktikante	48
505	Publikimi i konkurseve në Administratën Komunale	23
51	Publikimi i konkurseve për Arsimit dhe Shëndetësi	31
52	Publikimi i konkursit për Praktikantë me pagesë	2
53	Vendim për Formimin e Komisionit Rekrutues	22
54	Vendimi i komisionit per vlersimin e aplikacioneve te praktikanteve	1
55	Verifikimi paraprak i Aplikacioneve SIMBNJ	422
56	Njoftim për procedurat e rekrutimit-(verifikimi paraprak, test me shkrim, interviste, perfundimtar).	83
57	Vendim për refuzimi të Aplikacioneve	293
58	Testit me shkrim dhe Intervistë për procedurat e rekrutimit	40
59	Plotesimi i formularëve për kriteret	129
60	Vendim për anulim të konkursit	1
61	Njoftim për përfundimin e procedurës së rekrutimit e cila procedurë ka përfunduar pas verifikimit paraprak nuk ka plotësuar asnjë kandidat kriteret	1
62	Pjesëmarrja në komision rekrutuese në Drejtoratin për Arsim– test me shkrim dhe intervistë	9
63	Formular i vlerësimit të esesë dhe intervistes	40
	KERKESAT	
64	Kërkesë për Komision Disiplinor	2
65	Kërkesa për ID- kartela zyrtare	25
66	Kërkesë për DMZP për ndryshim te planit te personelit	2
67	Kërkesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës	1
68	Kërkesë për krijimin e qasjeve ne SIMBNJ për zyrëtare të rinjë	13
69	Kërkesë për pagesë retroaktive	7
	PERGJIGJET	
70	Përgjigje në kërkesë për masë disiplinore	1
71	Kompletimi i lëndëve për Këshillin të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	24
72	Përgjigje në kërkesa të ndryshme	21
	NJOFTIM	
73	Njoftim për arritjen e moshës së pensionimit	7
74	Njoftim për përfundimin e periudhës provuese	10
75	Njoftim për drejtorët e drejtoratave dhe udhëheqesit e sektoreve per kerkesa e pushimeve vjetore dhe ndjekja e trajnimeve	36
76	Njoftime të ndryshme	5
77	Njoftim për vlerësimin e rezultateve në punë	15

78	Njoftim ftesë /ftesë për komision disiplinor	2
79	Njoftim për vijueshmëri	1
	PËLQIME	
80	Pëlqim për Transferime	8
	REGJISTRAT	
81	Regjistri i trajnimeve	56
82	Regjistri për vijueshmëri për ASHI	10
	AUDITORET	
83	Auditim nga Auditorët e jashtëm	2
84	Plotesimi i pytesorve per auditoret e brendshëm	3
85	Plotesimi i pytesorit për MAPL	5
86	Konfirmimi i planit vjetor të punës	2
87	Vendim për strukturim të zyrtarëve	1
88	Akti për organizimin e brendshëm për klasifikimin e vendeve të punës në administratën komunale	2
89	Gjithsejtë	3094

TAKIME TË NDRYSHME

Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

SEKTORI PRONËSORO – JURIDIK

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë periodës raportuese është bërë përcjellja e dispozitave ligjore të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe akteve të miratuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës për implementimin e tyre në praktikë nga fushëveprimi dhe kompetenca e Komunës.

Gjatë kësaj periudhe me kërkesë të Kryetarit të Komunës konform dispozitave ligjore në fuqi janë përgadituar një numër i madh i akteve nga kompetenca e Kryetarit të Komunës dhe fushëveprimtaria e Komunës në përgjithësi.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Gjatë periodës raportuese të vitit 2025 janë përgatitur: Vendime, Shkresa të ndryshme, Pëlqime, Kontrata, dhe Propozim-Vendime për miratim në Kuvendin e Komunës nga kompetenca e Kryetarit të Komunës.

STATISTIKAT

Aktet e përgatitura nga Sektori Pronësoro-Juridik për vitin 2025:

Nr.	Aktet	Numri
1.	Vendime	6
2.	Shkresa	103
3.	Pëlqime	3
4.	Kontrata	7
5.	Propozim-Vendime	13
6.	Aneks Kontratë	1
	Totali	133

Sektori Pronësoro-Juridik ka pranuar lëndë nga Drejtorati i Administratës Komunale, Sektor të Komunës si dhe lëndë të parashtruar nga palët, në procedurë administrative janë pranuar gjithsej 245 lëndë, prej tyre të kryera 232 dhe në procedurë 13 lëndë.

TAKIME E NDRYSHME

Sektori Pronësoro-Juridik ka marrë pjesë në takim pune, trajnime të ndryshme profesionale dhe në komisione të ndryshme të angazhuara me Vendim të Kryetarit të Komunës.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (ZKKK) gjatë vitit raportues ka funksionuar si mekanizëm mbështetës për të kthyerit, familjet e riatdhesuara dhe komunitetet jo-shumicë, në koordinim të vazhdueshëm me institucionet qendrore dhe partnerët ndërkombëtarë.

Veprimtaria e ZKKK-së ka përfshirë identifikimin dhe trajtimin e 19 familjeve të riatdhesuara, për të cilat janë realizuar verifikime administrative dhe vlerësime sociale, si dhe janë lëshuar konfirmimet përkatëse. Në kuadër të strehimit, janë menaxhuar 6 kontrata për akomodimin e familjeve të riatdhesuara dhe 3 kontrata për azilkërkues.

Mbështetja sociale dhe humanitare është ofruar për familjet në nevojë përmes sigurimit të ushqimit, materialeve higjienike, druve të zjarrit dhe materialeve shkollore. Paralelisht, Komisioni Komunal për Riintegrim dhe Komisioni për Kthim të Qëndrueshëm kanë funksionuar në baza të rregullta, duke shqyrtuar dhe miratuar kërkesa për akomodim, kthim dhe ndihmë financiare.

Gjatë vitit janë trajtuar gjithsej 15 kërkesa për ndihmë financiare njëherëshe, nga të cilat 10 janë mbështetur nga fondet e ZKKK-së, ndërsa 5 nga fondi i Kryetarit të Komunës. Në fushën e banimit, është përmbyllur ndërtimi dhe pranimi teknik i një shtëpie për familjen Gecevic në Janjevë, si dhe është iniciuar ndërtimi i një shtëpie të re përmes vendosjes së gurthemelit, në bashkëpunim me MKK-në.

Në bashkëpunim me IOM-in janë realizuar projekte konkrete që përfshijnë ndriçimin publik në Lagjen e Re, mbështetje për biznese të vogla dhe pajisje për projekte individuale. Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërorganizativ është zhvilluar edhe me OSBE-në, GIZ-in, Caritas-in, URA-n, Roma Versitas Kosovo dhe institucione qendrore, me fokus në riintegrim, punësim dhe fuqizim socio-ekonomik të komuniteteve.

ZKKK ka trajtuar gjithashtu ankesa të qytetarëve dhe çështje pronësore, infrastrukturore dhe administrative, duke kontribuar në zgjidhje konkrete në terren. Është siguruar përfshirja e fëmijëve të familjeve të riatdhesuara në sistemin arsimor, si dhe janë realizuar transferime të nxënësve sipas nevojës. Të dhënat janë përditësuar rregullisht në bazat e të dhënave të MPB-së dhe MKK-së.

Gjatë vitit 2025 është vazhduar bashkëpunimi i strukturuar me institucione vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë MPB, MAPL, FSK, ROMACTED, UNHCR, GIZ, URA, IOM, UNDP dhe OSBE, ndërsa raportimi mujor i detajuar mbi aktivitetet dhe punën në terren është realizuar në vazhdimësi.

DREJTORATET KOMUNALE

DREJTORATI PËR ADMINISTRATË

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Në Drejtoratin për Administratë janë realizuar detyra dhe obligime në mbështetje të dispozitave ligjore në fuqi, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, statutit të Komunës së Lipjanit, ligjet tjera, Udhëzimet, Urdhëresat, si dhe Rregulloret tjera Komunale.

PUNËT DHEAKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUdhës RAPORTUESE

Përgjatë kësaj periudhe, në bashkëpunim me menaxherët kemi bërë evidentimin e kontratave që skadojnë përgjatë këtij viti, e që janë të ndërlidhura me Administratën si dhe i kemi proceduar tutje për Planifikim të Prokurimit për vitin vijues, si dhe janë bërë planifikime shtesë të nevojshme për Drejtoratin e Administratës.

Trajtimi i kërkesave dhe parashtresave të qytetarëve

Gjatë gjithë vitit 2025, sektori ka pranuar dhe trajtuar në mënyrë të rregullt dhe me prioritet kërkesat dhe parashtresat e qytetarëve, të cilat kanë përfshirë:

- Protokollimin e dokumenteve në intranetin komunal
- Shërbimet postare për shkresat zyrtare
- Përgatitjen dhe kthimin e përgjigjeve zyrtare ndaj kërkesave të qytetarëve
- Arkivimin dhe administrimin e dokumentacionit komunal

Një vëmendje e veçantë i është kushtuar shërbimeve për mërgimtarët, sidomos gjatë muajve të verës, duke mundësuar trajtimin e kërkesave të tyre në mënyrë të shpejtë dhe të lehtësuar.

Konkurse, aplikime dhe platforma E-Kosova

Gjatë vitit janë protokolluar konkurse dhe aplikime të ndryshme nga drejtoritë komunale, ndërsa të gjitha kërkesat e qytetarëve janë trajtuar brenda afateve ligjore.

Në kuadër të përdorimit të **platformës E-Kosova**, sektori ka ofruar vazhdimisht shërbime, konsultime dhe asistencë praktike për qytetarët. Shërbimet më të shfrytëzuara gjatë vitit kanë qenë:

- Shërbimet: 1, 2, 4, 5, 7, 8, 11, 16 dhe 25.

Gjithashtu, është ofruar asistencë për shërbimet e **Administratës Tatimore të Kosovës**, veçanërisht për shkarkimin elektronik të vërtetimeve tatimore.

Digjitalizimi i shërbimeve të gjendjes civile

Gjatë vitit 2025 janë përcjellë dhe promovuar shërbime të reja digjitale të gjendjes civile në platformën E-Kosova, përfshirë:

- Certifikata e vendbanimit
- Certifikata familjare
- Certifikata e statusit martesor
- Certifikata e shtetësisë
- Aplikimi për rifitim të shtetësisë (me autentifikim personal)

Në muajt nëntor dhe dhjetor, në QSHQ është lansuar **sistemi i monitorëve informues për qytetarët**, i cili u mundëson qasje të drejtpërdrejtë në shërbimet e digjitalizuara. Ky projekt është realizuar si **donacion nga Këshilli i Evropës**.

Sigurimi fizik në objektet komunale

Shërbimet e sigurimit fizik janë ofruar gjatë gjithë vitit në mënyrë të rregullt dhe profesionale, në koordinim të vazhdueshëm me kompaninë kontraktuese, duke garantuar sigurinë e objekteve komunale sipas kontratës në fuqi.

Menaxhimi i shërbimeve postare dhe materialeve shpenzuese

Si menaxher i kontratës për shërbimet postare universale, sektori ka mbajtur koordinim të vazhdueshëm me:

- Drejtorinë e Thesarit dhe Financave
- Drejtorinë e Prokurimit

Ky koordinim ka mundësuar raportimin korrekt, harmonizimin e faturave dhe ekzekutimin e pagesave për shërbimet e kontraktuara.

Në aspektin e materialeve shpenzuese, sektori ka siguruar furnizim të mjaftueshëm për funksionimin normal të shërbimeve administrative, edhe pse është evidentuar një përdorim i shtuar i letrës dhe shërbimeve të fotokopjimit për qytetarët.

Koordinimi i punëve dhe menaxhimi i pushimeve

Koordinimi i punëve ka qenë i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit me qëllim të garantimit të vijimësisë së shërbimeve për qytetarët. Pushimet vjetore të stafit janë menaxhuar në mënyrë të organizuar dhe pa penguar funksionimin normal të sektorit.

Menaxhimi i praktikantëve me pagesë

Gjatë vitit 2025 është realizuar koordinimi dhe menaxhimi i praktikantëve me pagesë në administratën komunale, përmes:

- Pranimi të raporteve të vijueshmërisë
- Administrimit të vendimeve dhe kontratave përkatëse
- Procedimit të dokumentacionit për realizimin e pagesave

Pjesëmarrja në debate dhe trajnime

Gjatë vitit janë realizuar aktivitete të rëndësishme zhvillimore dhe profesionale, ndër to:

- Pjesëmarrje në debate publike të organizuara nga D4D dhe Qendra YAHR
- Diskutime mbi digjitalizimin e shërbimeve komunale dhe platformën E-Komuna
- Trajnime të vazhdueshme nga IKAP, përfshirë:
 - “Parandalimi dhe zvogëlimi i barrës administrative”
 - “Mendimi dizajnues (Design Thinking)”
 - Punëtorja për digjitalizimin e shërbimeve dhe përdorimin e Platformës eKosova (26–27 nëntor 2025, Pejë)**
 - Në kuadër të aktiviteteve për avancimin e digjitalizimit të shërbimeve publike, përfaqësues të Sektorit të Administratës së Përgjithshme morën pjesë në Punëtorinë për digjitalizimin e shërbimeve dhe trajnimin e stafit të komunave rreth përdorimit të Platformës eKosova, e mbajtur më 26–27 nëntor 2025 në Pejë.
 - Gjatë kësaj punëtorie u trajtuan temat kryesore si në vijim:
 - Të arriturat në fushën e e-Qeverisjes dhe e-Shërbimeve gjatë vitit 2025
 - Ofrimi i shërbimeve përmes Platformës eKosova, me fokus në statistikat e shfrytëzimit
 - Bashkëpunimi dhe bashkërendimi i aktiviteteve ndërmjet ASHI-së dhe institucioneve komunale në ofrimin e shërbimeve digjitale
 - Mundësitë e digjitalizimit dhe integritet të shërbimeve administrative komunale në Platformën eKosova
 - Krijimi i profilit në eKosova dhe nivelet e shërbimeve – trajnim praktik
 - Shërbimet e nivelit komunal që ofrohen përmes eKosova, përfshirë eKomunat dhe Intranetin
 - Administrimi dhe menaxhimi i Platformës eKosova (CMS)
 - Roli i zyrtarëve komunal në përkrahjen dhe asistimin e qytetarëve për përdorimin e shërbimeve administrative në Platformën eKosova
 - Punëtorja shërbeu si platformë për shkëmbim përvojash ndërmjet komunave, forcim të kapaciteteve profesionale të stafit komunal dhe rritje të efikasitetit në ofrimin e shërbimeve digjitale për qytetarët.

Përfundim

Sektori i Administratës së Përgjithshme në QSHQ gjatë vitit 2025 ka përmbushur me sukses detyrat dhe përgjegjësitë e tij, duke kontribuar në rritjen e cilësisë së shërbimeve publike për qytetarët.

Fokusi i vazhdueshëm mbetet:

- Transparenca
- Profesionalizmi
- Avancimi i digjitalizimit

Përmirësimi i përvojës së qytetarëve në marrjen e shërbimeve publike

Shërbimet në formë tabelore- statistikore

Nr.	Emërtimi i Llojit të Punës	Sasia
-----	----------------------------	-------

•	Protokollimi i kërkesave, ankesave si dhe aktet tjera te personave fizik dhe juridik, në Qendrën për Shërbime me Qytetarë	
1	Kërkesa të regjistruara nga personat fizikë dhe juridik	15156
2	Kërkesa për arkivë	38
3	Kërkesa për mbajtës familje dhe shtesa për fëmijë jashtë vendit	494
4	Kërkesat gjendjes civile të regjistruara në sistemin e intranetit	38750
•	Pranimi dhe Dërgimi i shkresave bëhet nëpërmjet komunikimit zyrtar të brendshëm zyrtarit të postes së institucionit.	
5	Aktvendime të Shpërndara	255
6	Ftesa të Shpërndara	711
7	Vendime të Shpërndara	344
8	Fletëparaqitje për Gjykatë	21
9	Njoftime të Shpërndara	162
10	Të Arritura me Postë	784
11	Të Dërguara me Postë	1577
12	Fatura tatimore të Qirasë	49
13	E veçantë për të raportuar harxhimet në të holla për dorëzim në postë janë 2274,20€	
14	Gjithsej	58341

Sektori i Gjendjes Civile

Gjatë vitit 2025, Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Lipjanit ka ofruar shërbime për qytetarët në zyrën qendrore në Lipjan, si dhe në pesë zyra të tjera në lokalitetet: Janjevë, Gadime, Magurë, Kraishtë dhe Shalë.

Gjatë kësaj periudhe janë regjistruar dhe rishkruar:

- 162 lindje
- 313 martesë
- 70 shkurorizime
- 113 vdekje

Po ashtu janë proceduar:

- 304 akte/dëshmi vdekje
- 256 kërkesa për fitimin e shtetësisë
- mbi 50 ndërrime emrash
- kërkesa të ndryshme për korrigjime dhe përmirësime në të dhënat e gjendjes civile

Gjatë vitit janë hasur sfida lidhur me kushtet e punës dhe ofrimin e shërbimeve në terren, megjithatë shërbimet janë realizuar në mënyrë të rregullt dhe në përputhje me procedurat përkatëse.

Statistikat:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA
1	Ekstrakt i lindjes	29253
2	Certifikatë e martesës	6691
3	Certifikatë vdekje	3915
4	Certifikatë Vendbanimi	2924
5	Vërtetim nga arkiva	558
6	Certifikatë Shtetësie	384
7	Certifikatë e Statusit martesor	1476
8	Certifikatë të lindjes	14833
9	Deklarata e Bashkësisë familjare	6140
10	Regjistrimet e reja në LAL	160
11	Regjistrimet e mëvonshme në LAL	267
12	Regjistrimet e reja në LAM	460
13	Regjistrimet e më vonshme në LAM	86
14	Regjistrimet e reja në LAV	170
15	Regjistrimet e më vonshme në LAV	125
16	Aktvendime nga lëmin e gjendjes Civile dhe Akt Vdekje	170
17	Gjithësejt	67612

Sektori i Kuvendit

Përmbledhje e shkurtër e punëve që janë kryer gjatë kësaj periudhe kohore në Sektorin për Punë të Kuvendit dhe Komiteteveve si vijon: Është përegaditur materiali në mënyrë fizike, janë mbajtur procesverbale dhe janë hartuar ekstrakte për 6 mbledhje të

Kuvendit të Komunës, 6 mbledhje të Komitetit për politikë dhe financa,për 7 mbledhje të Komitetit për Komunitete, për 1 mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi si dhe për disa mbledhje të Komitetit per Arsim , Komitetit per shendetesi, Komitetit për Kulturë Rini e Sport. Për mbledhjet e sipërshënuara të Kuvendit është dërguar materiali në mënyrë elektronike Kryetarit, nënkryetarëve, drejtorëve, anëtarve të kuvendit, sektorit të informimit si dhe në ministrin përkatëse etj. punë të ngjajeshme si pregaditja e vendimeve e rregulloreve të aprovuara etj.

Aktet juridike nënligjore të aprovuara në Kuvend fillimisht janë dërguar në Ministrin përkatëse për të vlersuar ligjeshmërin e tyre mandej në publikim në vebfaqe e kështu me radhë për t’mundësuar plotfuqishmërin dhe zbatueshmërin e tyre.

Përveq kësaj gjatë këtij gjashtëmujori janë përkthyer dhe lektuar përveq materialeve për mbajtjen e mbledhjeve të sipërshënuara edhe 34 vendime dhe disa plane dhe strategji të aprovuara në Kuvend si dhe shum materiale tjera të ndryshme. Janë bërë edhe shumë orë përkthim simultant e gojor.

Vëlen të theksohet po ashtu, se gjatë kësaj periudhe janë mbajtur edhe dy (2) mbledhje solemne.

STATISTIKAT:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Mbajtja e procesverbalit nga mbledhjet e KK	6	93 faqe
2.	Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e KK	6	81 faqe
3.	Nxjerrja e Vendimeve dhe akteve të tjera nga mbledhjet e Kuvendit	34	79 faqe
4.	Përkthimi i Ekstrakteve	13	62 faqe
5.	Përkthime zyrtare-simultane në organe të ndryshme	29	70 orë
6.	Përkthimi i dokumenteve të ndryshme të Drejtorateve	86	330 faqe
7.	Përkthimi i shkresave të tjera	77	213 faqe
8.	Fotokopjimi	400	15500 faqe
9.	Mbajtja e Procesverbalit nga mbledhjet e KPF-së	6	35 faqe
10.	Nxjerrja e Ekstrakteve nga mbledhjet e KPF-së	6	29 faqe
11.	Mbajtja e procesverbalit dhe Nxjerrja e Ekstraktit nga mbledhjet e komiteve tjera dhe komisioneve të ndryshme	18	100 faqe
12.	Mbajtja e procesverbalit dhe nxjerrja e ekstraktit nga mbledhja e KKS	1	1 faqe
13.	Përgaditja e ftesave të ndryshme për mbledhje dhe tubime të ndryshme.	25	240 faqe
14.	Përgaditja e rexhistrave të ndryshëm (për meditet e anëtarve të Kuvendit dhe komiteve e të ngjajshme).	36	60 faqe
15.	Të ndryshme(dërgimi i dokumenteve për veb faqe,dokumente të skenuara në MAPL etj. të ngjajshme)	260	1200 faqe
16	Rregullore,Plan, Korrniza e të ngjajshme-	0	0
17	Lektorim të materialeve të ndryshme (rregullore, vendime ekstrakte,raporte,ftesa etj. të ngjajëshme)	224	371 faqe
19.	Gjithsejt	1227	18251 faqe
			Përveq kësaj që pasqyrohet me faqe janë edhe 200 orë përkthim gojor

Sektori për mirëmbajtje dhe operim

Në sektorin për mirëmbajtje dhe operim të gjitha punët janë kryer sipas obligimeve që kemi, deri te mirëmbajtja dhe sigurimi i veturave dhe gjendjen e tyre e vazhdueshme teknike, si dhe kontrollimi i karburanteve të shpenzuara.

Të gjitha veturat janë të pajisura me pjesë kontrolluese.

Statistikat:

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASI	SHËNIM
1	Furnizim me lëndë djegëse - karburant për gjenerator dhe mesatarja e harxhimeve.	/	619.6
2	Furnizimi me lëndë djegëse /naftë/ për ngrohje qendrore	/	
3	Furnizim me lëndë djegëse – karburant për automjete	222	14415.31 Litra
4	Evidentimi i kilometrave të kaluara të automjeteve dhe mesatarja e shpenzimeve.	222	184749 km mes; 780 lit/100 km
5	Harxhimet e ujit të pijshëm	/	m³
6	Furnizim me material teknike për mirëmbajtje të objekteve	/	
7	Furnizim me material higjenik		
8	Ndërrimi – meremetimi i dorëzave për dyer të drurit	46	
9	Rregullimi dhe debllokomi i ujit nyjën sanitare		
10	Mirëmbajtja e higjienës në sipërfaqe	/	3200 m²
11	Mirëmbajtja e parkut - kositja e barit,	/	
12	Sërvisimi i automjeteve	25	

13	Sërvisimi i gjeneratorëve	/	
14	Sërvisimi i kalldatorëve	/	
15	Sërvisimi i centralit kundër zjarri (Alarmi)	/	
16	Sërvisimi i aparateve kundërzjarri	40	
17	Bartja e zyrtarëve komunalë në trajnime-Prishtinë me Kombi	592	
18	Vazhdimi i regjistrimit të automjeteve	13	
19	Mirëmbajtja e teknologjisë kompjuterike	/	
20	Vendosje e pompave zhytëse në pishinë	/	
21	Kërkesa për vetura zyrtare	2238	
	Gjithsej	3398	

Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore

Gjatë periudhës janar–qershor 2025, Njësia për të Drejtat e Njeriut dhe Barazi Gjinore ka zhvilluar aktivitete të ndryshme në bashkëpunim me institucione publike, organizata vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e kapaciteteve institucionale, avancimin e barazisë gjinore dhe promovimin e mosdiskriminimit.

Janë mbajtur takime pune, punëtori dhe trajnime lidhur me bashkëpunimin ndëretnik, zbatimin e Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore, integrimin gjinor në politikat komunale, buxhetimin gjinor, si dhe hartimin e strategjive komunale për rini dhe veprim rinor lokal.

Po ashtu, Njësia ka marrë pjesë në kolegji, aktivitete monitoruese dhe punëtori për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve komunalë dhe këshillave përkatëse. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar edhe takime të rregullta me palë në zyrë, shqyrtim i kërkesave ndërsektoriale, ofrim i këshillave për projekte dhe mbështetje financiare, si dhe punë të tjera administrative.

STATISTIKAT:

Trajnime	Takime	Debate	Tryezë e rrumbullakët	Të ndryshme
15	14	1	/	Këshilla dhe sugjerime me palë në zyrë 85

DREJTORATI PËR SHËNDETËSI DHE PËRKUJDESJE SOCIALE

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale gjatë vitit 2025 është fokusuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Veprimit për Kujdes Parësor Shëndetësor 2020-2025, Strategjinë dhe Planin Veprimit për Përfshirjen Sociale 2022-2025, Planin e Punës së DHSPS-së për vitin 2025 si dhe Planin e Punës së QPS-së dhe ShBK për vitin 2025.

Objektiv i përgjithshëm i shëndetësisë gjatë këtij viti ka qenë vendosja e pacientit dhe komunitetit në fokus duke ofruar shërbime cilësore përmes përmirësimit të qasjes në shërbime, modernizimit të proceseve, përmirësimit të ambientit të punës brenda institucioneve shëndetësore, modernizimit të teknologjisë si dhe zhvillimit të kapaciteteve njerëzore të personelit shëndetësor. Ngritja e performancës së shëndetësisë në Komunën e Lipjanit dhe renditja në vendin e parë në Kosovë, nga matjet e bëra vitin e kaluar dhe të publikuara këtë vit nga institucionet kredibile vendore dhe ndërkombëtare, ka ndikuar në rritjen e motivit të personelit shëndetësor dhe ka ndihmuar në arritjen e objektivave të përcaktuara në Planin e Punës për vitin 2025.

Spektori i laboratorit ka avancuar dukshëm. Ky sektor është furnizuar me aparaturë dhe pajisje të reja shëndetësore të cilat kanë ndikuar në rritjen e numrit të shërbimeve të ofruara, saktësi dhe shkurtim të kohës së pritjes. Në muajin tetor të vitit 2025, QKMF në Lipjan ka pranuar si donacion një analizator biokimik/imunokimik. Si rezultat, ne kemi filluar të ofrojmë edhe 5 analiza të reja laboratorike për diagnostikimin e sëmundjeve të tiroides si: TSH, T3, T4, Anti-TPO, Anti-TG.

QKMF në Lipjan ofron 48 analiza/teste laboratorike. Kjo është një e arritur e madhe ngase ofrimi i një numri kaq të madh të testeve ka ndikuar drejtpërsëdrejti në përmirësimin e mëturjes së shërbimeve shëndetësore, lehtësimin e punës së personelit shëndetësor, në përmirësimin e mirëqenies dhe shëndetit publik të qytetarit. Jemi ndër komuna të pakta që ofrojmë numër kaq të lartë të analizave.

Nga muaji janar i vitit 2026 QKMF në Lipjan do të ofroj 49 analiza laboratorike, duke shtuar edhe një analizë shtesë, asaj të troponinës. Të gjitha përgatitjet për ofrimin e kësaj analize laboratorike janë bërë në vitin 2025. Ky test është shumë i rëndësishëm ngase përmes tij bëhet vlerësimi nëse ka dëmtim të muskullit të zemrës. Niveli i lartë i troponinës tek pacienti tregon mundësinë e ndonjë problemi akut kardial. Ky test mundëson intervenimin e hershëm dhe zvoglimin e rrezikut nga sulmet në zemër të pacientëve tek të cilët mjeku dyshon duke u bazuar në simptomat e paraqitura.

QKMF Dr. "Mejdi Zejnullahu", është bërë anëtare e Rrjetit të Spitaleve që Promovojnë Shëndetin (SPSH) duke pranuar zyrtarisht certifikatën e anëtarësimit gjatë një ceremonie të mbajtur në Pejë më 24 qershor 2025. Ky moment forcon më tej integrimin e Komunës së Lipjanit dhe Kosovës në platformën ndërkombëtare të SPSH-ve, duke shënuar një hap tjetër të angazhimit për promovimin e shëndetit dhe kujdesin e përqendruar te pacienti. Përveç anëtarësimit individual të QKMF-së, Kosova tani ka rrjetin e vet kombëtar të institucioneve të SPSH, që mund të shërbejë si model për t'u ndjekur nga institucionet e tjera të kujdesit shëndetësor në vend.

Kjo ngjarje pasqyron angazhimin në rritje për t'i pajisur profesionistët e kujdesit shëndetësor në Kosovë me njohuritë dhe mjetet e nevojshme për parandalimin e sëmundjeve. Sipas Prof. Oliver Groene QKMF në Lipjan tani do të jetë pjesë e një komuniteti dhe së shpejti do të lansohet një kurs masiv online, falas, për të gjithë anëtarët e Rrjetit të Spitaleve që Promovojnë Shëndetin. Kujdesi primar shëndetësor, respektivisht QKMF në Komunën e Lipjanit ka vazhduar edhe në këtë periudhë me qenë qendër demonstruese nga projekti AQH. Këtë e ka mundësuar angazhimi i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm drejt përmirësimit të kushteve të punës dhe të shërbimeve shëndetësore nga ana e personelit shëndetësor dhe menaxhmentit.

Bashkëpunimi me projektin AQH edhe në këtë periudhë ka vazhduar me qenë i shkëlqyeshëm. Janë organizuar shumë trajnime, takime, tryeza, aktivitete për promovimin dhe edukimin shëndetësor si dhe aktivitete tjera për menaxhimin e sëmundjeve kronike jongjithësë dhe përmirësimin e shëndetit publik.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2025 kujdesi primar shëndetësor në Lipjan ka ofruar 536965 vizita dhe shërbime shëndetësore.

Është realizuar objektivi strategjik krijimi i kushteve infrastrukturore për implementim të plotë të mjekësisë familjare respektivisht zonimit, në shumicën e institucioneve shëndetësore në Lipjan. Këto përmirësime të dukshme infrastrukturore kanë ndikuar drejtpërdrejt në organizimin më të mirë të punës, përmirësimin e kushteve për mjekët dhe infermierët si dhe krijimin e mundësive për ofrim dhe marrje të shërbimeve më kualitative mjekësore.

Fuqizimi i stafit infermior dhe mjekëve familjar është duke dhënë rezultat të mirë. Në QKMF ordinancat e mjekëve familjar janë duke funksionuar mirë. Stafi infermior është i kyqur drejtpërdrejtë në shërbim. Ndarja e detyrave të stafit infermior dhe bashkëpunimi i duhur në mes të infermierëve dhe mjekëve familjar gjatë ofrimit të shërbimit është duke ndikuar drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së shërbimeve.

Planifikimi i hershëm për fuqizimin dhe përmirësimi i shërbimeve të urgjencës ka dhënë rezultate të mira. Shërbimi i urgjencës është plotësuar me numër të nevojshëm të mjekëve dhe infermierëve. Kushtet e punës janë përmirësuar në këtë shërbim. Urgjenca është e furnizuar me aparatura dhe pajisje të reja mjekësore si dhe autovetura të mirëmbajtura mirë dhe të gatshme për intervenim për shërbime akute dhe urgjente.

Shërbimi i integruar për personat e prekur me sëmundjet kronike jo ngjitësë si diabet, hipertension dhe astma është duke funksionuar mirë. Në këtë vit ne kemi vazhduar të ofrojmë këtë shërbim të pavarur. Gjatë kësaj periudhe sa jemi të pavarur, ne kemi arritur progres të theksuar.

Te shërbimi i integruar, mbetet të fuqizohet pjesa e shërbimit social si pjesë integruese e këtij shërbimi duke siguruar zyrtar të mjaftueshëm dhe të disponueshëm për kryerjen e vlerësimeve në terren së bashku me personelin shëndetësor.

Spektori i stomatologjisë është zhvendosur në objektet e komunës në rrugën Isa Olluri, për shkak të punimeve në rregullimin e infrastrukturës së jashtme në QKMF. Kjo ka ndikuar në vështirësimin e punës së përsoneit në këtë sektor dhe në përgjithësi në rënien e shërbimeve.

Vazhdimi i aplikimit të qasjes strategjike më ndryshe dhe pragmatike në vitin 2025, hartimi i një plani të veprimit si dhe hartimi i një plani të punës të thjeshtë, të matshëm dhe të realizueshëm brenda një viti kalendarik kanë rezultuar të suksesshme dhe kanë ndikuar drejtpërdrejtë në:

- Avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore në kuadër të mjekësisë familjare,
- Avancimin e shërbimeve laboratorike duke bërë rritjen e numrit të analizave të ofruara në gjithsej 48 parametra dhe shkurtimin e kohës për ofrim të analizave,
- Ofrimin e shërbimeve të mamografisë për të gjitha gratë e interesuara mi moshën 40 vjeçare si dhe eliminimin e tërësishëm të kohës së pritjes në shërbimin e radiologjisë diagnostike,
- Ofrimin e shërbimeve të paliativit,

- Realizimin e planit të vaksinimit me sukses,
- Rritjen e numrit të shërbimeve stomatologjike dhe rritjen e sigurisë gjatë ofrimit të shërbimeve,
- Rritjen e shërbimeve dhe vizitave për nënat në sektorin e maternitetit dhe gjinekologjisë dhe
- Avancimin dhe përmirësimin e kushteve të punës për personelin shëndetësor të angazhuar në ofrim të shërbimeve në institucionet shëndetësore në Lipjan.

Duke marrë për bazë se preventiva, edukimi dhe identifikimi i hershëm sëmundjeve zvogëlon rrezikun për sëmundje, paaftësi dhe vdekje, gjatë këtij viti kemi intensifikuar aktivitetet tona në zvogëlimin e sëmundshmërisë përmes promovimit dhe edukimit shëndetësor të popullatës. Janë mbajtur shume fushata vetëdijësuese.

Në mënyrë që stafi menaxherial dhe mjekësor të ofrojnë shërbime shëndetësore cilësore kemi fuqizuar mekanizmat e mbikëqyrjes mbështetëse dhe menaxhimit të cilësisë, jemi angazhuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore, janë marrë masat për parandalim të infeksioneve dhe janë zbatuar nga gjithë profesionistët shëndetësor.

Kemi punuar ngushtë me Qendrën për Punë Sociale (QPS-në) me qëllim të identifikimit të vështirësive, sfidave dhe avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve sociale.

Aktivitetet e planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë për Përfshirjen Sociale 2022-2025 të aprovuar nga Kuvendi Komunal janë duke u implementuar.

Gjendja në Shtëpinë me Bazë në Komunitet në vitin 2025, duke përfshirë edhe shëndetin e rezidentëve, në përgjithësi ka qenë e mirë. Është bërë avancim i mëtutjeshëm i kushteve për rezidentet dhe punëtorët e Shtëpisë me Bazë në Komunitet duke siguruar kujdes, higjienë, mirëmbajtje dhe ushqim të mirë për rezidentët si dhe kushte të mira për stafin.

Punimet në ndërtimin e objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit dhe në infrastrukturën e jashtme kanë vazhduar. Stomatologjia dhe materniteti janë duke funksionuar përkohësisht në objektin e Komunës në rrugën Isa Olluri në Lipjan.

Punët dhe aktivitetet e realizuara në vitin 2025

Në fillim të vitit kemi hartuar dhe dorëzuar Planin e Punës për vitin 2025. Në këtë plan kemi vendosur objektiva strategjike specifike dhe reale, të matshme dhe të realizueshme me afatet kohore të përcaktuara. Më tutje, secilën specifikë e kemi zbërthyer në aktivitetet më të rëndësishme duke kostuar secilin aktivitet.

Po ashtu, për zyrën e Kryetarit të Komunës së Lipjanit kemi përgatitur dhe dorëzuar Raportin Vjetor për vitin 2024 në të cilin raport kemi pasqyruar punën e institucioneve shëndetësore të KPSH-së në Komunën e Lipjanit, punën e Qendrës për Punë Sociale, Banim Social, Shtëpisë me Bazë në Komunitet si dhe punën e Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

Është zhvilluar kampanja informuese për përzgjedhjen e mjekut familjar e udhëhequr nga MSh. Qytetarët e komunës së Lipjanit janë informuar se si mund të aplikojnë në e-Kosova për përzgjedhjen e mjekut të tyre familjar.

Dhoma për Promovim dhe Edukim Shëndetësor (këshillimorja), e zgjeruar dhe e plotësuar me staf, është duke ofruar shërbimet e kujdesit të integruar për pacientët geriatrik 65+ me sëmundje kronike jo ngjitëse si diabeti, hipertension, astma etj. Shërbimi i integruar për personat e prekur me sëmundjet kronike jo ngjitëse është duke funksionuar mirë. Përkrahja direkte e AQH për këtë projekt ka përfunduar. Ne kemi siguruar qëndrueshmërinë dhe edhe në këtë vit ne kemi vazhduar të pavarur të ofrojmë këtë shërbim.

Sipas raportit të pranuar nga QKMF, kjo periudhë raportuese ka qenë e sukseshme në realizimin e planit të vaksinimit dhe Komuna e Lipjanit është ndër komunat me përqindje të lartë të realizimit të imunizimit.

Qasja në institucionet shëndetësore dhe ato të kujdesjes sociale ka vazhduar të përmirësohet. Ekranet për informim, pjerrinat dhe ashensorët e montuar në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe në QPS në Lipjan kanë ndikuar tek personat me aftësi të kufizuara ngase ju kanë ofruar qasje të lirë në marrje të shërbimeve shëndetësore si dhe në informim.

Avancimi i shërbimeve të cekura më lartë në përmbledhje, por jo vetëm, është bërë duke zgjeruar komunikimin me personelin mjekësor, komunikimin në mes të personelit shëndetësor dhe pacientit si dhe anasjelltas. Në këtë drejtim, na ka ndihmuar shumë këshilli i pacientëve i cili është duke bërë punën e tij, e cila vlerësohet si punë e mirë.

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është duke u bërë avancim dhe jemi duke e përcjellur për së afërmi këtë proces. Përmirësimi i kushteve të punës për stafin mjekësorë dhe për pacientin si

dhe ofrimi i shërbimeve adekuate është trajtuar me kujdes. Për së afërmi është monitoruar furnizimi i ordinancave me material dezinfektues dhe higjienik si dhe pajisja e secilës ordinancë dhe sallë me çarçaf të ri. Kujdes i veçantë i është kushtuar higjienës në ambientet e institucioneve shëndetësore në Komunën e Lipjanit me qëllim të ofrimit të sigurisë për pacientin dhe personelin shëndetësor. Si rezultat, është shënuar avancim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së.

Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është kryer me rregull dhe me sukses, sipas kërkesave nga shefat e sektorëve, mirëpo furnizimi me barna dhe material mjekësor nga Ministria e Shëndetësisë nuk është bërë në tërësi. Furnizimi me insulinë kryesisht ka qenë i kënaqshëm ndërsa furnizimi me barna për hipertension nuk është bërë me rregull nga depo qendrore e Ministrisë së Shëndetësisë, ka pasur mungesë për periudha të gjata kohore dhe kemi hasur në probleme të mëdha.

Të gjitha shërbimet në QKMF dhe institucionet shëndetësore në terren janë mbuluar me personel të mjaftueshëm mjekësor. Më tutje, pajisjet mjekësore kanë qenë funksionale gjatë gjithë muajit. Megjithatë, vërehet ende një përdorim i lartë i infuzioneve dhe injeksioneve në trajtimin e pacientëve, si dhe ngarkesë e madhe në laborator dhe në shërbimin e radiografisë.

Bashkëpunimi me AQH-në rreth implementimit të planeve dhe projekteve për insitucionet shëndetësore në Komunën e Lipjanit ka qenë i shkëlqyeshëm.

Siç kemi vepruar edhe viteve të fundit, në muajin qershor dhe muajin nëntor kemi bërë përgatitjet për rritjen e kapaciteteve dhe riorganizimin e punës në QKMF me qëllim të ofrimit të shërbimeve shëndetësore dhe përballje me rritjen e numrit të pacientëve si pasojë e rritjes së temperaturave dhe ardhjes së bashkëatdhetarëve nga diaspora gjatë muajve korrik, gusht, dhjetor dhe janar.

Në këtë periudhë raportuese kemi përkrahur projektin kujdesi për nënat e reja dhe fëmijët deri në moshën tre vjeqare. Do të vazhdojmë me përkrahjen.

Projektet kapitale të realizuara dhe në proces janë si vijon:

- Ndërtimin i objektit të ri të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit – në proces.
- Projekti Rregullimi i Infrastruktursë së Jashtme të Qendrës Urgjente në Qytetin e Lipjanit– në proces.
- Projekti Adaptimi i Objektit të Vjetër të QKMF-së për nevoja të përsoneve me aftësi të kufizuara.
- Pranimi i Analizatorit Biokimik/Imunokimik si donacion.
- Pranimi i një Ultrazëri të teknologjisë së avancuar si donacion me bashkëfinancim nga projekti AQH.

Në muajin qershor kemi ndërmarrë hapa konkret për fuqizim të shërbimit të urgjencës dhe përgatitjen për sezonin e verës, e cila shoqërohet me ngarkesë të shërbimeve. Shërbimi i Urgjencës ka burime të mjaftueshme njerëzore, kushte të mira logjistike dhe barna e material medicinal të mjaftueshëm për intervenime të shpejta akute dhe urgjente. Automjetet kanë qenë në gjendje të rregullt në sigurimin e ofrimit të shërbimit dhe servisimet janë kryer me kohë.

Kemi vizituar Qendrat e Mjekësisë Familjare në Magure, Shalë, Gadime dhe Janjevë si dhe Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Dobrajë të Madhe. Nga vizitat e bëra jemi ndarë të kënaqur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore në këto institucione. Më tutje, me personelin shëndetësor kemi diskutuar dhe jemi njoftuar me sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen dhe kemi ofruar bashkëpunim të ngushtë në lehtësimin e punës dhe avancimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore.

Është mbajtur takimi i parë i vitit 2025 i Komitetit Drejtues për Kujdesin Parësor Shëndetësor në QKMF-Lipjan si qendër demonstrimi dhe ekselence. me pjesëmarrjen e përfaqësuesve nga MSh, AQH, SDC dhe DSHPS.

Është bërë shënimi i ditëve botërore të shëndetit publik duke organizuar aktivitete të ndryshme. Në këto aktivitete morën pjesë pacientë me sëmundje kronike jo ngjitëse mbi moshën 65 vjeç, anëtarë të këshillit të pacientëve, përfaqësues nga AQH, MSh, IKSHPK dhe përfaqësues të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve. Këto aktivitete janë organizuar nga Drejtoria e DSHPS-së dhe QKMF Lipjan me mbështetje nga AQH. Një ndër aktivitetet e zhvilluara ka qenë shënimi i ditës botërore të zemrës në sheshin Adem Jashari. Ky aktivitet ka pasur ndikim të mirë në ndërgjegjësimin e pacienteve për shëndetin e zemrës dhe edukimin e pacienteve për stilin e shëndetshëm të jetesës, ndalimin e duhanit, shtimin e aktiviteteve fizike, dietën e shëndetshme, etj. Poashtu, ne kuadër të PESH, është bërë organizimi i fushatave për ndërgjegjësimin mbi diabetin dhe hipertensionin.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare QKMF

Gjatë vitit 2025, QKMF-Lipjan ka ofruar shërbime shëndetësore me këtë përbërje të stafit:

Stafi mjekësorë	Nivesli i arsimimit	Meshkuj	Femra	Numri i punëtorëve gjithësejt
Specialist të Mjekësisë Familjare	Superior/Specializim nga mjekësia familjare 26	13	13	26
Mjekë të Përgjithshëm	Superior/Master i mjekësisë së Përgjithshme 20	10	11	21
Doktor i Stomatologjisë	Superior/Master i Stomatologjisë 10	5	5	10
Specialist Radiolog	Superior/Specializim në Radiologji 1	1	0	1
Specialist i Pediatrisë	Superior/Specializim në Pediatri 1	1	0	1
Specialist Gjinekolog-Obstetër	Superior/Specializim në Gjinekologji me Obstetrikë 2	2	0	2
Specialist i Biokimisë	Superior/Specializim në Biokimi-Klinike 1	1	0	1
Teknik Laborant mjekësorë	Bachelor-4, Shkolla e mesme - 8	8	4	12
Infermier/e	Shkolla e mesme= 86 Bachelor=29	17	95	112
Mami	Shkolla e mesme-12	0	12	12
Teknik të stomatologjisë	Shkolla e mesme-6	2	3	5
Teknik të radiologjisë	Shkolla e mesme-3	2	2	4
Punëtor teknik	Shkolla e mesme-19, shkolla e mesme e ulet-4	12	11	23
Punëtor në administratë	Skollim superior-4 Shkollim i mesëm-4	7	1	8
Gjithësej numëri i punëtorëve	Shkollim superior=62, Shkollim Bachelor=37, Shkollimi i mesëm=137, Shkollimi i mesë i ulët = 4	81	157	238
Numri i të punësuarve nga komuniteti jo shumice	Shkolla e mesme-3	0	2	2
Numri i punëtorëve me nevoja të veçanta	Shkolla Fillore- 2, Shkolla e mesme-2	3	1	4

SHËRBIMET SHËNDETËSORE TË OFRUARA

Shërbimet Mjekësore dhe Infermiore

	Totali i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në vitin 2025: 536965	
	Viti 2025-Vizitat Mjekësore	
1	Vizita mjekësore nga mjeku familjar /përgjithshëm në QKMF	104891
2	Vizita mjekësore nga mjeku familjar /përgjithshëm në Punte	57598
3	Vizita mjekësore pediatrike	4508
4	Vizita mjekësore sjinekologjike	3469
5	Vizita mjekësore stomatologjike	7877
6	Vizita mjekësore pulmologjike	514
7	Vizita mjekësore emergjente	63562
8	Vizita në kujdesin paliativ	3589
9	Total	246008
	Viti 2025- Sherbime Shëndetësore	
1	Injeksione	100710
2	Infuzione	50498
3	Pastrim lidhje	19722
4	RTG	5440
5	Laborator	30381
6	Lindje	0
7	Largim i penjve	1030
8	Imobilizime të traumave	554
9	Oksigjenoterapi	1190
10	EKG	5873
11	Mamografi	317
12	USG	1307
13	Vizita shtepiake me autoambulancë	1395
14	Transport me autoambulancë	1020
15	Vizita në Stacionin Policor	0
16	Vizita në Qendren e Azilit - Magure	32
17	Vizita në Qendren e Paraburgimit	279
18	Rrahje	61
19	Këmbësor i lënduar me automjet	7
20	Konstatim vdekje	169
21	Plagosje me armë zjarri	0
22	Thumbim i rrigrave	124
23	Aksidente trafiku	401
24	Dhunë familjare	30

25	Exitus letalis / mortus ad latae	0
26	Këshillimorja	28375
27	Vakcina	11481
29	Sherbime stomatologjike	6437
30	Referime	20478
31	Inhalime	432
32	Vizita infermierike gjinekologjike	234
33	Vizita për nëna dhe fëmijë 0-3 vjet	429
34	Klasa për nëna	709
33	Gjithsej shërbime	290957

Numri i referimeve për konsultime në nivelin sekondar dhe terciar në këtë vit ka qenë 20478, në përqindje **8.32%**. Kjo përqindje është brenda standardit, i cili është deri në 20%.

Krahasimi ndër vite i vizitave mjekësore dhe shërbimeve shëndetësore

Nga kjo tabelë mund të konstatojmë se numri i vizitave dhe shërbimeve është rritur me rreth **120.3%** nga viti 2010 deri në vitin 2025.

Kurse stafi mjekësor dhe mbështetës në vitin 2010 ishte **230** punëtor, kurse në vitin 2025 **238** punëtor.

Kjo lehtësisht paraqet nevojën e shtimit të stafit në të gjithë sektorët për arsye se janë rritur shërbimet shëndetësore të cilat ofrohen në kujdesin parësorë shëndetësorë në Komunen e Lipjanit.

Shëndeti i Nënës dhe Fëmijës

- Kontrolla të rregullta për gratë shtatzëna,
- Imunizim i fëmijëve sipas kalendarit shtetëror,
- Këshillim shëndetësor për nënat dhe prindërit, si dhe vizita në shtëpi për nëna dhe fëmijë deri në 3 vjeç.

Aktivitetet parandaluese

- Edukim shëndetësor në komunitet dhe shënimi i ditëve botërore, si dhe organizimi dhe realizimi i ekskurzioneve në bashkëpunim dhe bashkëfinancim me AQH. Janë zhvilluar dy karvane shëndetësore, dy ekskurzione në Parkun Nacional Blinaja, si dhe shënimi i ditës së zemres dhe diabetit.
- Promovim i stilit të shëndetshëm të jetesës ecja ne natyre me pensionist 65+ te cilet kane dhe semundje kronike jo ngjitëse (Diabet Hipertension arterial dhe Astma)

Statistika kryesore të QKMF-së

Vizita dhe Shërbime:

- Numri i pergjithshem i vizitave dhe shërbimeve shëndetësore në vitin 2025 ka qenë 536965.
 - Numri i vizitave Shëndetësore ka qenë 246008.
 - Numri i vizitave të shërbimeve shëndetësore ka qenë 290957.
- Rastet e referuara në spitale terciare kanë qenë 20478, apo shprehur në përqindje 8.32%.

Burimet njerëzore

Gjatë vitit 2025 janë pensionuar gjithësej shtatë punëtor, nga të cilët sipas pozites një Mjekë Familjarë, një teknik i rëntgenit, një laborant, dy infermiere dhe dy punëtoe higjieniste.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar si punëtor të ri: tre mjekë të përgjithëshëm, dy infermier/e, një asistente e stomatologjisë, një punëtor teknik në QMF-Shalë gjithësej shtatë punëtorë. Më tutje, janë plotësuar pozitat shef/e emjekëve në QKMF, Shef/e e Sektorit të Stomatologjisë, Shef/e e sektorit të Maternitetit si dhe zyrtarja e cilësisë, gjithësej katër pozita menaxheriale. Në fund të vitit 2025 në listen e pagave kan qenë 238 punëtor.

Edikimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP):

Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP) për personelin shëndetësor ka vazhduar në QKMF në mënyrë sistematike. Janë mbajtur ligjërata mbi shërbimet shëndetësore të integruara dhe kujdesin antenatal, me pjesëmarrjen e mjekëve dhe infermierëve dhe është realizuar nga 90% e punëtorëve. Nga 10% të punëtorëve të pa trajnuar me EVP janë kryeshishtë punëtoet e mirëmbajtjes dhe një pjesë e administrates.

Në kuadër të EVP,shtatë mjekë nga QKMF kanë kryer çertifikimin për ECHO, me përkrahje nga AQH.

Departamenti i Mjekësisë Familjare

Puna me mjekë ka qenë e organizuar mirë si dhe është bërë mbulimi i punkteve përveç AMF-Smallushë dhe AMF-Banullë, të cilat janë jashtë funksionit si pasojë e numrit të vogël të pacientëve.

Përkrahja nga AQH në këtë viti ka vazhduar dhe është shtrirë në disa fusha si: zhvillimi i vazhdueshëm profesional, kujdesi i integruar, menaxhimi cilësor i shërbimeve, investime kapitale, fuqizimi i këshillit të pacienteve, si dhe zbatimi i projektit Qendrat Demonstruese në QKMF, QMF-Gadime dhe AMF-Kraishtë.

Edhe përkundër problemeve teknike si rënia e kohëpaskohshme e serverit të SISH-it në Ministrinë e Shëndetësisë dhe rrjetit, është shënuar një rritje në përdorimin e Sistemit Informativ Shëndetësor SISH.

Sektori i Infermierisë

Në sektorin e infermierisë është arritur koordinim i mirë në organizimin dhe shpërndarjen e punëve si në kryerjen e raportimeve me kohë, planifikimin dhe shfrytëzimin e pushimeve pa penguar procesin e punës. Po ashtu, është bërë planifikimi i trajnimeve të stafit dhe shënimi i ditëve të caktuara në shëndetësi.

Shërbimi i Urgjencës

Shërbimi i urgjencës në QKMF ofron shërbime 24 orë në ditë dhe është duke vazhduar të përmirësohet dukshëm. Ky shërbim është fuqizuar shumë me resurse njerëzore dhe tani stafi i Urgjencës përbëhet nga 9 mjek dhe 16 Teknik/Infermiere si dhe njësia e transportit me nga 1 vozitës për çdo ndërrim (4 ndërrime), me pajisje dhe automjete për intervenim të shpejtë.

Planifikimi dhe mobilizimi me kohë për përballim të numrit të madh të pacientëve gjatë ardhjes në pushim të mërgimtareve në sezonin e verës dhe gjatë festave të fund vitit ka dhënë rezultate të mira. Kjo qasje ka rezultuar e suksesshme.

Sektori i Laboratorit

Në vitin 2025, shërbimi i laboratorit ka rritur numrin e analizave të ofruara nga 43 sa ishin në vitin paraprak në 48 analiza. Këto teste laboratorike lejohen dhe specifikohet me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet administrative për kujdesin parësor shëndetësor UA 04/2020. Për të krijuar këtë mundësi, laboratori është pajisur me aparaturat e nevojshme shëndetësore bashkëkohore si: aparat biokimik, numërues hematologjik, mikroskop, dhe aparatura tjera për nevoja të këtij shërbimi si në QKMF ashtu edhe në punkte. Kjo aparaturë e mirë tani ka mundësuar ofrimin e analizës HbA1c/Hemoglobina e glikogjenizuar.

Sektori i Radiologjisë Diagnostike

Kemi realizuar aktivitete për Ndërgjegjësimin për Kancerin e Gjirit për muajin tetor 2025. Janë përfshirë të gjithë akterët relevant dhe është hartuar lista me aktivitete.

Numri i ekzaminimeve mamografike të kryera në QKMF gjatë kësaj periudhe raportuese ka qenë i ulët. Gjithsej janë ekzaminuar 317 gra. Ky numër është shumë i ulët, marrë parasysh dobinë shëndetësore të këtij shërbimi dhe ndikimin e tij në shëndetin publik, Andaj, marrë parasysh këtë, ne jemi duke konsideruar mundësitë dhe alternativat për të rritur numrin e ekzaminimeve mamografike.

Sektori i Stomatologjisë

Sektori i Stomatologjisë është zhvendosur përkohësisht Në sektorin e stomatologjisë kemi vazhduar të ofrojmë pakon me shërbimet e kompletuara stomatologjike duke filluar nga fotografimi, shërimi, mbushja, nxjerrja e dhëmbit dhe pastrimi. Ky përmirësim në këtë sektor është arritur duke bërë riorganizimin e stafit dhe përmirësimin e kushteve të punës.

Sektori i Maternitetit

Ky shërbim është orientuar drejt vizitave gjinekologjike-obstetrike, vizitave shtëpiake dhe këshillave për nëna dhe fëmijë deri në tre vjeç, po ashtu edhe klasa për nëna. Vizitat gjinekologjike-obstetrike kryhen nga dy mjek gjinekolog.

Sektori i Vaksinit

Sipas raporteve të pranuar nga QKMF, kjo periudhë raportuese ka qenë e suksesshme në realizimin e planit të vaksinit dhe Komuna e Lipjanit është ndër komunat me përqindje të lartë të realizimit të imunizimit.

Po ashtu, është realizuar edhe vaksinimi kundër gripit sezonal për personat e shtyer në moshë dhe ata me sëmundje kronike jongjitesë.

Sektori i Barnatores

Është bërë avancim i mëtutjeshëm në planifikimin, shpërndarjen si dhe evidentimin e stokut të barnave. Furnizimi me material mjekësor dhe laboratorik është realizuar sipas kërkesave të dorëzuara nga shefat e sektorëve përkatës. Megjithatë, bazuar në

raportet e QKMF-së, furnizimi me barna dhe materiale nga Ministria e Shëndetësisë ka qenë i pjesshëm, rreth 65% e planifikimit, çka paraqet një sfidë të vazhdueshme në ofrimin optimal të shërbimeve.

Sektori i Mirëmbajtjes

Në fushën e sigurisë shëndetësore, si komponentë e menaxhimit kualitativ të shërbimeve mjekësore, është bërë avancim i theksuar. Është shënuar përparim i dukshëm në mirëmbajtjen dhe pastërtinë brenda ambienteve të QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve.

Sektori i Autogazhës

- Në shërbimin e autogazhës kanë qenë gjithësej 10 automjete nga të cilat dy autokombi për hemodializë, tri autoambulanca (vetëm njëra e kompletuar me pajisje), katër automjete të terenit dhe një e vkasinit.
- Shpenzime në servisimin dhe mirëmbajtjen e këtyre automjeteve 11884.36 Euro
- Shpenzime në derivate njësi matëse liter, gjithësej 27284.60 L
- Kilometrat e kaluara me këto automjete gjithësej 245852 km
- Shpenzimet mesatare 11.09l/100 km.

Konkluzione

Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në Kujdesin Primar Shëndetësor në komunën e Lipjanit ka arritur të ndërtoj një besueshmëri të qytetarët/pacientët.

Investimet në infrastrukturë, në ambientet brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore, si dhe investimet në aparaturat dhe pajisjet mjekësore kanë ndikuar në avancimin e mëtutjeshëm të shërbimeve shëndetësore.

Më tutje, në avancimin e shërbimeve shëndetësore ka ndikuar organizimi i trajnimeve të shumta në të cilat kanë marrë pjesë të gjithë personeli i interesuar shëndetësor.

Përkundër vështirësive, nuk është ndërprerë asnjë shërbim shëndetësor në Kujdesin Primar në Komunën e Lipjanit dhe janë realizuar: **246008** vizita mjekësore dhe **290957** shërbime shëndetësore, gjithësej: **536965** vizita dhe shërbime shëndetësore.

QEBDRA PËR PUNË SOCIALE – QPS

Qendra për Punë Sociale është i vetmi institucion publik me kompetencë profesionale si pikë referimi dhe menaxhimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për individët dhe familjet në nevojë për mbështetje materiale dhe profesionale në kuadër të shërbimeve sociale dhe familjare.

Qendra për Punë Sociale (QPS) në Lipjan ka realizuar aktivitet në kuadër të veprimtarisë për shërbime sociale dhe familjar në harmoni me legjislacionin dhe plan- programin e punës, për përmbushjen e objektivave në mbështetje të grupeve në nevojë dhe të cenueshme në komunitet.

Aktivitetet kryesore:

- Realizim i shërbimeve sociale dhe familjare në kuadër të kërkesave të qytetarëve në nevojë për shërbime në QPS.
- Aktivitet në realizimin e kërkesave të qytetarëve në nevojë për Partneritete publike-privat Bashkëpunim me UNICEF, AQH dhe institucione relevante për mbështetje të fëmijëve, personave të rritur dhe të moshuar.
- Avancimi i kornizës organizative dhe administrative, inicimi i kërkesave për plotësimin e vendeve të punës sipas standardeve strukturore.
- Aktivitet rreth hartimit dhe implementimit të Strategjisë për Strehim Familjar Aktivitet koordinues me SOS Fshatrat për realizimin e objektivave të strategjisë.
- Pjesëmarrje në trajnime, punëtori për mbrojtje të fëmijëve, personave me AK, dhuna në familje, kundër diskriminimit, shërbimet e integruara për fëmijë dhe të moshuar, siguria, prona, buxheti, barazia gjinore, mbikëqyrja, etj.
- Aktivitet në realizimin dhe menaxhimin e tryezave multidimensionale sipas Rregullores Nr. 23/2023, për mbrojtja e fëmijëve me rrezik të mesëm dhe të lartë.
- Implementim i Strategjia PAK 2025–2027. Zbatimi i aktiviteteve socio-ekonomike dhe planifikimi buxhetor.
- Shërbime për azilkërkues Ndihmë sociale, kujdestari, shërbime profesionale, pjesëmarrje dhe avokim për individët dhe familjet me status të mbrojtjes ndërkombëtare (Qendra e Azilit Magure).

- Ri-integrim dhe mbështetje Aktivitet me MPB për familjet e ri-atdhesuara; pilotimi i masave të veçanta për familjet në nevojë (SAS).
- Bashkëpunim me sektorin publik Organizatat vendore dhe ndërkombëtare (Shoqata Bereqeti, OFAP, CRPK, MFPT) për mbështetje të grupeve me status jo të mirë socio-ekonomik.
- Planifikim dhe raportim. Implementim i planeve mujore, periodike dhe vjetore në SHS, SHNS, SHAF; hartimi i planeve buxhetore dhe të prokurimit për vitin 2026 -2028.

Objektivat e realizuara.

- Mbështetje profesionale dhe materiale për fëmijët pa përkujdesje prindërore, si dhe ofrimi i formave alternative të mbrojtjes.
- Bashkëpunim dhe realizim i MM me organizata të licencuara për mbështetje psikologjike dhe këshilluese për të miturit viktime të dhunës seksuale.
- Shërbime terapeutike-fizike dhe psiko-sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara (Qendra e Kujdesit Ditor, Lipjan).
- Qasje reale për PAK në institucion.
- Shërbime cilësore dhe të qasshme për personat mbi 65 vjet dhe nënat me foshnje, mbështetur nga AQH dhe UNICEF.
- Kontribut rreth analizës/ave, për përmirësimin e shërbimeve sociale.
- Bashkëpunim me gjykatat, polici, prokurori dhe media për çështje sociale. Përmbushje e aktivitetit në kuadër të plan – programit QPS.

SHËRBIMI SOCIAL-PROFESIONAL

Qendra për Punë Sociale (QPS), si institucion kopetent për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare, brenda kompetencës ligjore, profesionale dhe territoriale të komunës, i është përgjigjur kërkesave të qytetarëve për shërbime sociale dhe familjare, siç përcaktohen në Ligjin për Shërbimet Sociale dhe Familjare, duke realizuar përkujdesje sociale, këshillim dhe në raste të veçanta, ndihmë materiale për klientët në nevojë sociale. Grupi i synuar përfshin:

- fëmijët pa kujdes prindëror; fëmijët me sjellje asociale;
- delinkuentë të mitur;
- marrëdhëniet e çrregulluara familjare;
- sëmundje trupore ose aftësi të kufizuara fizike;
- aftësi të kufizuar mendore; sëmundje mendore;
- rrezik nga shfrytëzimi apo abuzimi;
- dhuna në familje, trafikimi njerëzor;
- Varësi nga alkooli ose droga, fatkeqësitë natyrore ose të shkaktuara ose emergjencat, ose shkaqe të tjera që i bëjnë personat nevojtarë.

Për mbulimin e nevojave të grupeve në nevojë dhe me cenueshmëri, janë angazhuar stafi i SHS/QPS, përmes partneritetit publik-privat me OJQ të licencuara në ofrimin e shërbimeve të specializuara dhe të përkujdesjes në komunitet.

Shërbimi Social në Qendrën për Punë Sociale në Lipjan, gjatë këtij viti raportues është angazhuar në arritjen e objektivave për ngritjen e kapaciteteve profesionale e kadrove, në zbatimin e legjislacionit dhe në ofrimin e shërbimeve sociale sa më cilësore dhe me kohë, pavarësisht përballjes me sfida për shkak të deficitit në zyrtar profesional dhe reformave ligjore.

Shërbimi social brenda kësaj periudhe rezultoi të përmbush të gjitha kërkesat e qytetarëve duke ju përmbajtur procedurave standarde të veprimit për menaxhimin e rasteve dhe në realizimin e objektivave të përcaktuara me plan-program, veçanërisht duke kryer funksioni e “Organit të Kujdestarisë”, përmes trupës së ekspertëve të fushës në mbrojtje të fëmijëve dhe të rriturve në nevojë për SHS.

Klientët dhe shërbimet sociale

Klientët	Numri i rasteve	Shërbimet	Numri i shërbimeve
Fëmijët e braktisur	/	Fëmijë të braktisur	/
Fëmija jetim.	1	Vendosja e fëmijëve në shtëpinë transitorë	6
Klient për familje strehuese –streh.fam.	2	Vendosja në strehim familjar.	3
Kujdestari për fëmijët e pa shoqëruar me status të huaj	1	Kujdestaria	3
Fëmijët me prindërve të penguar në kryerjen e detyrave.	8	Shërbime për të miturit në konflikt me ligjin	512

Fëmijët e keqtrajtuar (lënë pas dore)	15	Vendosja e fëmijëve në adoptim vendor	1
Fëmijët me sjellje asociale	36	Vlersime për të miturit që kërkojnë të hynë në martesë	1
Të miturit në konflikt me Ligjin(delikuentet)	217	Këshillim për bashkëshortet në martesë	29
Viktimat e dhunës në familje	50	Besim i fëmijëve dhe mbikëqyrja e vizitave prindërore	54
Mendime profesionale për të mitur në gjykatë	96	Intervenime për viktimat	390
Viktimat e trafikimit	1	Intervenime të përgjithshme	124
Viktimat e vendosura në strehimore për viktimat e dhunës	4	Shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuar	10
Martesa e parakohshme që dëshirojnë të hynë në martesë	21	Shërbime për të rritur me aftësi të kufizuar	2561
Klient në nevojë për Këshillime martesore	28	Shërbime për moshuarit (AQH)	8
Kolient në nevojë për shërbime	513	Këshilla psiko- sociale	52
Klient vendor të cilët kërkojnë fëmijë për adoptim	5	Sanim i marrëdhënieve familjare.	2
Reintegrimi i fëmijëve	6	Intervenime gjatë orarit të kujdestarisë.	97
Viktimat e krimeve seksuale	3	Përfaqësues të përkohshëm	29
Fëmijët me Aftësi të kufizuara	52	Pjesëmarrja në seanca Gjyqësore e ZSHS-ve	68
Të rritur me aftësi të kufizuar	5	Bashkimi familjar – kthimi në familje	7
Total nr. i përgjithshëm i klientëve:	1157	Nr. i përgjithshëm i shërbimeve:	4278

STREHIMI FAMILJAR DHE PÛRKRAHJA MATERIALE E FAMILJEVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR

Deri më tani nuk është nxjerrë ndonjë plan rregullues i hollësishëm pasi që me HZK mbulohet mjaftueshëm rregullimi hapësinor i tërë territorit.

Shtrirja urbane

Zona e lejuar për ndërtim ***në territorin e Komunës së Lipjanit*** sipas HZK është 5233.73 hektar, duke përfshirë zonat banimore dhe afariste.

Shtrirja urbane e qytetit

Qyteti i Lipjanit si zone kadastrale ka 914.12 ha, kurse kufiri i zones urbane banimore është 412.26 ha. Pjesa urbane e destinuar për afarizën më qytetin e Lipjanit është e ndërlidhur me zonat kadastrale fqinje dhe përfshinë hapësirën e përgjithshme prej 625.55 ha.

Qyteti është i ndarë në 9 zona urbane. Për secilen zonë është përcaktuar destinimi dhe kushtet e ndërtimit.

Në ZK të Lipjanit janë më shumë se 3317 objekte, prej tyre 167 janë objekte banimi me më shumë se dy njësi banimi. Sipërfaqja e këtyre objekteve rreth 55 ha, që përfshinë rreth 6% të sipërfaqes së përgjithshme të ZK në Lipjan.

Sipërfaqja e planifikuar ndërtimore në ZK të Lipjanit është mëse e mjaftueshme edhe për një periudhë të gjatë kohore. Po ashtu edhe kufijt e planifikuar ndërtimor në vendbanimet rurale përfshijnë hapësirë të mjaftueshme edhe për një kohë të gjatë. Mirëpo

është karakteristike se shumë ndërtime po zhvillohen jashtë kufijëve ndërtimore, duke pasur parasysh se investitorët po i shfrytëzojnë pronat e tyre.

Në kuadër planifikimit hapësinor duhet veçuar aktivitetet themelore të zhvilluara në vitin 2025 si:

Monitorimi i zbatimit të Hartës Zonale të Komunës. Hartimi dhe miratimi i Raportit monitorues për periudhën 2 korrik 2024 deri me 3 korrik 2025 për zbatimin e qëllimeve dhe objektivave të përcaktuara me HZK.
Në Raport është dhënë vlerësimi për nivelin e zbatueshmërisë së HZK dhe janë prezantuar sfidat që e kanë përcjellur DPUMM për zbatueshmërinë e këtij dokumenti planor.

Me procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) për periudhën 2023-2031 kemi arritur në finalizimin e draftit qysh në vitin 2023. Po ashtu është finalizuar Draft Raporti i VSM-së për PZHK-në dhe me datën 13 nëntor 2023 është dorëzuar në MMPHI për shqyrtim dhe miratim. Që nga ajo kohë të dy dokumentet janë “ngrirë” për shkak të kërkesës së MMPHI për përfshirje në këto dy dokumente të “Deponisë së re sanitare”.

Në kuadër të Grupit punues për Raportimin e performancës komunale për vitin 2024, nga fushëveprimi i DPUMM-së janë trajtuar fushat:

- Planifikimi hapësinor;
- Mbrojtja e mjedisit; dhe
- Hapësirat publike.

Në kuadër të aktiviteteve të tjera të realizuara përfshihen:

- Hartimi i detyrave projektuese për projektet e ndryshme infrastrukturore. Në këtë kontekst DPUMM në bashkëpunim me drejtoratet përkatëse dhe kompanitë projektuese ka finalizuar gjithsejtë 27 projekte komunale të fushave si:
 - Infrastrukturë rrugore;
 - Nga fusha e infrastrukturës mjedisore;
 - Infrastrukturë shoqërore/sociale.

Të gjitha projektet janë dorëzuar dhe proceduar për zbatim pranë Drejtorateve përkatëse.
Tri kërkesa për detyrë projektuese janë ceduar në organet tjera për shkak të rrethanave të caktuara.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE VJETORE NË FUSHËN E URBANIZMIT

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave të ndryshme të parashtruara nga palët, si dhe ka kryer aktivitete të tjera të caktuara.

Nga viti 2024 në vitin raportues janë bartur 19 lëndë, kurse gjatë vitit 2025 janë pranuar 763 lëndë të natyrave të ndryshme. Nga numri i përgjithshëm prej 782 lëndëve janë shqyrtuar 745 lëndë apo 95.3%. Prej tyre janë miratuar gjithsejtë 479 lëndë, të refuzuara 217 së bashku me 5 lëndë legalizimi të vendosura në listë të pritjes, pushim procedure 6 lëndë dhe të ceduara 43 lëndë. Për shqyrtim në vitin 2026 barten 37 lëndë, prej tyre 22 në proces të legalizimit.

Shënim:
Nga 72 kërkesa të pranuar në muajin dhjetor, vetëm nga data 26 dhjetor e deri me 31 dhjetor 2025 janë pranuar 37 kërkesa të natyrave të ndryshme. Ky numër i kërkesave të pranuar ditëve të fundit të muajit dhjetor ka ndikuar në numrin e lëndëve të bartura në muajin vijues. Meqenëse me 31.12.2025 përfundon afati i aplikimit për legalizim të objekteve, është parashtruar një numër i konsiderueshëm i kërkesave të kësaj natyre (26 të tilla).

Shqyrtimi i lëndëve në fushën e urbanizmit

Nr.	Llojet e kërkesave	Kërkesa të pranuar në 2025	Kërkesa të bartura nga 2024	Miratu.	Refuz.	Pushim i proced.	Ceduar	Në proces
1.	Kushte ndërtimore	111	5	67	42	1	4	2
2.	Leje ndërtimi	93	6	61	33	1		4
3.	Vazhdim i Lejes ndër.	2		2				
4.	Plotësim/ndryshim i Lejes ndërtimore	1			1			
5.	Njoftim për shkelje të Lejes Ndërtimore	1					1 ²	

6.	Vazhdim i Kushteve ndërtimore	5		4	1			
7.	Ndryshim i Kushteve ndërtimore	4		3	1			
8.	Leje renovimi	1		1				
9.	Leje rrënimi	21		13	3	2	2	1
10.	Ndërrim i destinimit të ndërtesës	3			3			
11.	Ndarje e lokaleve në ndërtesë	2			2			
12.	Shndërrimi i tokës bujq. në t. ndërtimi	2		1	1			
13.	Certifikatë përdorimi	5		1	2			2
14.	LMK	63	5	47	20			1
15.	Certifikatë legalizimi	79	1	31	22			22
16.	Legalizim Listë e pritjes				5			
17.	Qasje në dokumente	15		13	2			
18.	Emërtim rruge, adresa	15		2	5		8	
19.	Informacione urbane	75	1	70	6			
20.	Akte nga MMPHI me efekte juridike	17		13	3	1		
21.	Kërkesë nga MMPHI për dorëzim dokum.	1		1				
22.	Vendim nga MMPH për refuzim kërkesë	1					1	
23.	Akte të kthyer nga MMPHI	2					2	
24.	Vendime nga MMPHI për leje mjedisore	9		9				
25.	Njoftime nga MKRS për shtyerje të afat.	7		5			2	
26.	MKRS – shpallja e Janjeves si zonë e mbrojtur	1		1				
27.	MKRS – lista e objekteve të trashëgimisë kulturore	2		2				
28.	MKRS- QRTK - vendime	6		6				
29.	Dorëzim i projektit në MKRS	3		3				
30.	Akte nga gjykata me efekt juridik	1		1				
31.	Dokumente për ekspert gjyqësor	3		3				
32.	Bashkim/ndarje e parceles	74		36	35	1	1	1
33.	Panele solare në objekt	10		5	4			1
34.	K. ndërtimore për park solar	4					1	3
35.	Pëlqime parimore për rrjet energjetik	6		3	3			
36.	Zhvendosje e rrjetit energjetik	1			1			
37.	Punime në rrjet energjetik	1			1			
38.	Lejim i punimeve në ujës. KUR –Pr.	5		3	2			
39.	Tërheqje e lëndës	28		28				
40.	Ankesa të ndryshme	9		1	2		6 ³	
41.	Ankesa ndaj vendimeve për legal.	8			8			
42.	Detyrë projektuese	30		27			3	
43.	Mbushje parcele	1			1			
44.	Prerje asfalti	1					1	
45.	Vendosje e objekteve të përkohshme	2			2			
46.	Kërkesë për mbrojtje mjedisore	1					1	
47.	Ndërtim muri	1			1			
48.	Shfrytëzim i hapësirës publike	2					2	
49.	Inspektime të rrezikut në ndërtesa	2					2	
50.	Raporte të inspektorëve të ndërt.	3		3				
51.	Cenim i pronës	1					1	
52.	Kompenzim prone	1					1	
53.	Verifikim prone	1			1			

54.	Qasje në rrugë	1			1			
55.	Dëshmi për certifikatë përdorimi dhe legaliz.	2		2				
56.	Korrigjim lënde	1		1				
57.	Kërkesë për pezullim lënde	1			1			
58.	Kërkesë për mosnjohje të pëlqimit për ndërtim	1		1				
59.	Zhvendosje e shtylles elektrike	1			1			
60.	Kërkesë për respektim të kritereve për ndërt.	1		1				
61.	Të tjera	12	1	7	2		4	
	Totali	763	19	479	217	6	43	37⁴

Të dhënat lidhur me fillimin e ndërtimeve sipas lejeve ndërtimore të lëshuara në vitin 2025 duhet të sigurohen nga inspektorët e ndërtimit.

Leja ndërtimore ka afat prej një viti për fillimin e punimeve, prandaj disa ndërtime ka mundësi që nuk kanë filluar.

Gjithsejtë lëndët e pranua dhe shqyrtuara në vitin 2025

Lëndë të pranua në vitin 2025	Të bartura nga v. 2024	Gjithsejtë lëndë në vitin 2025	Të shqyrtuara në vitin 2025	Përqindja	Të bartura në vitin 2026
763	19	782	745	95.3	37

Lëndët e pranua dhe shqyrtuara në vitin 2024 – për qëllime krahasimi

Lëndë të pranua në vitin 2024	Të bartura nga v. 2023	Gjithsejtë lëndë në vitin 2024	Të shqyrtuara në vitin 2024	Përqindja	Të bartura në vitin 2025
723	104	827	808	97.7	19

Duhet theksuar se përkundër kapaciteteve të pamjaftueshme njerëzore (2 pozita pune të pambuluara dhe një punonjësi për rreth 9 muaj në pushim mjekësor) në periudhën e vitit 2025 janë shqyrtuar 745 kërkesa krahasuar me 808 kërkesa të trajtuara në periudhën e njëjtë të vitit 2024. Kjo ka ndikuar që shqyrtimi i lëndëve të arrij shifren e përgjithshme prej 95.3%. Duke i pasur parasysh këto rrethana, vlerësojm se kishte një efikasitet të mirë në shqyrtimin e kërkesave, kurse mbetja prej 37 lëndëve për vitin vijues ka të bëjë me lëndët e pranua në javën e fundit të muajit dhjetor 2025.

Trajtimi specifik i kërkesave për Leje ndërtimore sipas kategorisë dhe destinimit - 2025:

Kategoria e ndërtimeve	Nr. i lejeve	Destinimi	
		Banim	Afariste
I.	20	10	10
II.	41	19	20
Gjithsejtë	61	29	30

Në vitin 2025 janë pranuar 93 kërkesa për leje ndërtimi të kategorive të ndryshme dhe 6 të tjera kanë qenë të bartura nga viti paraprak. Prej 99 lëndëve, janë shqyrtuar 95 lëndë apo 96%. Të miratuara janë 61 leje ndërtimi apo 64.21% krahasuar me numrin e kërkesave të shqyrtuara. Të kategorisë së I-rë janë dhënë 20 leje ndërtimi dhe 41 të kategorisë së II-të. Numri i ndërtesave për banim dhe atyre afariste është i përafërt. Kjo tregon se investimet në fushën e banimit edhe më tutje janë tejet të larta.

Pjesë e veçantë e shqyrtimit të kërkesave është edhe procedura e lëshimit të konkluzioneve për pagesën e taksave sipas kategorive për leje ndërtimore, për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore për leje mjedisore komunale, për leje rrënimi dhe Konkluzion për certifikatë legalizimi. Për këto kategori janë lëshuar gjithsejt 197 konkluzione.

Shfrytëzimi i tokës dhe sipërfaqja ndërtimore

Në vitin 2025 janë shfrytëzuar për ndërtim gjithsejtë 319104.60 m2 apo 31 hektar e 91 ari sipërfaqe tokësore. Nga kjo sipërfaqe për banim janë shfrytëzuar 108434.36 m2 apo 10 hektar 84 ari e 34 m2, kurse për afarizëm 210670 m2 apo 21 hektar e 6.7 ari.

Zona e lejuar për ndërtim në territorin e Komunës së Lipjanit është 5233.73 hektar. Dhënia e lejeve ndërtimore gjatë vitit 2025 në sipërfaqen e caktuar përfshinë sipërfaqen tokësore të lejuar për ndërtim prej 0.59%.

Në këto të dhëna nuk përfshihen ndërtimet pa leje, për të cilat nuk ka të dhëna DPUMM.

Të dhënat specifike lidhur me sipërfaqen tokësore për ndërtim dhe sipërfaqen ndërtimore prezantohen në tabelat në vijim:

Sipërfaqja tokësore e shfrytëzuar për ndërtim dhe sipërfaqja ndërtimore për banim sipas lejeve të ndërtimit për vitin 2025

Kategoria ndërtimore	Sipërfaqe tokësore në m2	Gjithsejtë sipërfaqe ndërtimore në m2	Banim në m2	Afarizëm në m2
Kat. I	5362	1965.21		
Kat. II	103072.36	137600.28 ⁵	115273.26	22327.02
Gjithsejtë	108434.36	139565.49		

Sipërfaqja tokësore e shfrytëzuar për ndërtim afarist dhe sipërfaqja ndërtimore afarsite sipas lejeve të ndërtimit për vitin 2025

Kategoria ndërtimore	Sipërfaqe tokësore në m2	Gjithsejtë sipërfaqe ndërtimore në m2
Kat. I	20434	6110.70
Kat. II	190236	75576.46
Gjithsejtë	210670	81687.16

Sipërfaqja e përgjithshme tokësore dhe ndërtimore e shfrytëzuar sipas lejeve të ndërtimit për vitin 2025

Kategoria ndërtimore	Sipërfaqe e përgjithshme tokësore në m2	Gjithsejtë sipërfaqe ndërtimore në m2
Kat. I	25796.00	8075.91
Kat. II	293308.60	213176.46
Gjithsejtë	319104.60	221252.37

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE NË PROCESIN E LEGALIZIMIT TË OBJEKTEVE PA LEJE NDËRTIMI

Në kuadër të këtyre objektivave, DPUMM ka zhvilluar aktivitetet për udhëheqjen e procedurave administrative për shqyrtimin e kërkesave për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi.

Gjatë vitit 2025 në procedurë shqyrtimi kanë qenë 80 lëndë për trajtimin e objekteve pa leje ndërtimi. Të bartura nga viti 2024 ishte vetëm 1 lëndë, kurse gjatë vitit 2025 janë pranuar 79 lëndë.

Të gjitha lëndët e pranura gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar brenda afateve ligjore.

Statusi i shqyrtimit të lëndëve paraqitet në tabelen në vijim:

Lëndët e pranura dhe shqyrtuara

Nr.	Lëndë legalizimi	Pranuar në 2025	Bartur nga 2024	Miratur	Listë pritjes	Refuz.	Pezull.	Procedurë
1.	80	79	1	31	5	22	-	22

Karakteristikë e veçantë të shumica absolute e kërkesave për legalizim është dokumentacioni i pa kompletuar, dhe çështjet e pa rregulluara pronësore. Dokumentacioni i pakompletuar ndikon në kohën që duhet shpenzuar për ato kërkesa.

Në 8 raste janë parashtruar Ankesa ndaj Vendimeve për refuzimin e dhënies së certifikates së legalizimit. Të gjitha ankesat janë shqyrtuar brenda afateve ligjore dhe me vendimet përkatëse janë njoftuar parashtruesit e tyre.

REALIZIMI I OBJEKTIVAVE NË FUSHËN E BANIMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT

Në kuadër të objektivave vjetore në fushën e banimit dhe mbrojtjes së mjedisit janë realizuar këto aktivitete:

Në fushën e banimit, **përkatësisht sistemit të adresave** ka vazhduar aktiviteti i regjistrimit zyrtar të adresave. Lidhur me këte Agjencia Kadastrale e Kosovës përmes Bankës Botërore ka angazhuar 2 punonjës të cilët do të punojnë deri në fund të muajit shkurt 2026.

Lejet mjedisore komunale të lëshuara

Sipas legjisllacionit në fuqi Lejet mjedisore komunale (LMK) lëshohen për një numër të caktuar të objekteve të kategorisë së II-të. Gjatë vitit 2025 janë trajtuar 68 kërkesa, ku prej tyre janë miratuar 47 kërkesa.

Në shqyrtimin e lëndëve për leje mjedisore komunale trajtohen aspektet si: identifikimi i ndikimeve në mjedis në tokë, ajër, ujë, florë dhe faunë, gjenerimi i mbeturinave dhe grumbullimi tyre, zhurma, procesi teknologjik i punës, masat në raste të aksidentit, masat për rehabilitimin e sipërfaqës gjelbëruese si dhe masat për efikasitetin e energjisë. Po ashtu caktohet lokacioni i kontejnerëve në situacion, sipërfaqja e gjelbërt, mbjellja dhe lokacionet e drunjëve etj.

Me qëllim që këto ndikime të kontrollohen kurse ato negative të mund të zvogëlohen në nivel të “pranueshëm”, synohet edhe rehabilitimi i hapësirave të degraduara gjatë ndërtimit dhe realizimit të projekteve të ndryshme.

- Në fushën e Mjedisit po ashtu është bërë identifikimin në terren i deponive ilegale të mbeturinave dhe të dhënat i kemi digjitalizuar në sistem GIS.

Të dhënat për numrin e zbatimit të LMK-ve, duhet t’i prezantoj Drejtorati i Inspektoratit.

Realizimi i objektivave në fushën e banimit dhe mbrojtjes së mjedisit

Në kuadër të shënimit të Dites së Tokës me 22 prill është realizuar java e tokës me aktivitetet që përkojnë me këtë ditë.

DPUMM ka qenë i angazhuar në projektin e nivelit kombëtar “Menaxhimi i mbeturinave” – projekt i cili i mbështetë komunat lidhur me hartimin e planeve për menaxhimin e mbeturinave.

Gjatë këtij viti zyrtari për mbrojtje të mjedisit ka marrë pjesë në seminare dhe takime të ndryshme të organizuara nga institucione vendore e ndërkombëtare si:

-Zyrtari për mbrojtjen e mjedisit ka marr pjesë në punëtorinë “Climate Fresk”, e zhvilluar më 16 janar 2025. Kjo punëtori është organizuar nga Shoqata e Ndërgjegjësimit për Klimën (CAA), e mbështetur nga Helvetas Swiss Intercooperation, projekti DEMOS.

- Janë zhvilluar aktivitete vëdijsuse mbi faktorët e ndotjes së mjedisit natyror gjatë javës së Tokës.

-Në fushën e Mjedisit po ashtu kemi bërë identifikimin në terren të deponive ilegale të mbeturinave dhe i kemi digjitalizuar në sistem GIS.

- Identifikimi i sektorëve të lumenjëve për pastrim dhe njëkohësisht lokacionet e tyre janë dërguar në Autoritetin Rajonal të Pellgjeve Lumore.

-Përgatitja dhe dërgimi i informatave për çështjet mjedisore – dërguar Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës – MMPHI;

- Është bërë identifikimi dhe është hartuar raporti për ndërtesat me materiale asbesti;

- Pjesëmarrja në punëtorinë për paisjen e pjestareve të komuniteteve me statusin e “Palë me interes” e organizuar nga GIZ dhe SHPRK.

KRYERJA E DETYRAVE

Aktivitetet e caktuara janë realizuar në një masë të konsiderueshme dhe vlerësojmë se janë realizuar në përputhje me kërkesat ligjore.

Arritja themelore në fushën e urbanizmit është shqyrtimi me kohë (brenda afateve ligjore) i të gjitha lëndëve të pranuar. Janë bartur në vitin 2026 vetëm lëndët që janë pranuar ditëve të fundit dhe të gjitha ato janë brenda afateve ligjore për shqyrtim. Po ashtu kemi arritur t’i shqyrtojmë të gjitha lëndët për legalizim.

Megjithatë, nuk kemi arritur të realizojmë të gjitha detyrat e planifikuara për vitin 2025.

Detyrat themelore të pa realizuara

1.1. Në kuadër të planifikimit hapësinor nuk është përfunduar dhe miratuar Plani Zhvillimor Komunal, për shkaqet e theksuara më lartë.

1.2. Në fushën e mbrojtjes së mjedisit nuk kemi arritur të hartojmë dhe miratojmë Planin Lokal të Veprimit në Mjedis. Edhe ky projekt është i lidhur me “fatin” e Planit Zhvillimor Komunal.

KOMUNIKIMI DHE TRANSPARENCA

Në kryerjen e aktiviteteve të caktuara, DPUMM ka komunikuar me palët sipas interesimit të tyre dhe në raste të caktuara, palët janë ftuar për shqyrtimin e çështjeve të ndryshme lidhur me kërkesat e parashtruara.

Në faqen zyrtare të internetit janë publikuar format e kërkesave të nevojshme që parashtrohen nga palët dhe informacione të tjera nga fusha e planifikimit dhe ndërtimit. Po ashtu janë të publikuara edhe aktet përkatëse nënligjore që ndërlidhen me planifikimin urban dhe çështjet e ndërtimeve.

Puna e DPUMM është e hapur dhe aktet e duhura janë publikuar në faqen zyrtare të internetit. DPUMM përmes njësisë përkatëse iu ka përgjigjur të gjitha kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Po ashtu në kuadër të detyrave të caktuara, DPUMM ka zhvilluar disa aktivitete në bashkëpunim me njësitë tjera organizative të Komunës dhe në formë të hapur për publikun.

DPUMM i ka të publikuara në faqen zyrtare të Komunës të gjitha dokumentet planore, formularët për aplikim për çështje urbane së bashku me udhëzimet përkatëse dhe po ashtu publikon për çdo vit listen e lejeve të lëshuara ndërtimore.

REKOMANDIMET

Të arrihet zgjidhja lidhur me finalizimin e PZHK-së;

Të hartohen planet në fushën e mjedisit (PLVM, për cilësinë e ajrit, plani për mbrojtje nga zurma dhe plani për biodiversitet);

Të rishikohen taksat për leje ndërtimore.

DREJTORATI PËR GJEODEZI DHE KADASTËR

PËRMBLEDHJE E PERGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtoria e Kadastrit dhe Gjeodezisë –Zyra komunale Kadastrale e Komunës së Lipjanit,ka vazhduar të bëj ofrimin e shërbimeve efikase për qytetarët, duke ofruar informacione ,dhe azhurnime të ndryshme sipas detyrës zyrtare .

Sektori i Gjeodezisë

Në sektorin e gjeodezisë në vitin 2025 kemi pasur shumë kërkesa nga persona fizik për realizimin e punëve gjeodezike si: regjistrimi ndarjeve , bashkim i parcelave dhe punë tjera ku jemi munduar që me mundësitë ti kryekmë kërkesat e tyre, ku janë kryesisht ndarja e parcelave që personat e ndryshëm ti kryejnë trashëgimitë për rregullimin e qështjeve që lidhen me pronën e paluajtshme

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Të pranuar	Nga viti paraprak	Gjithsej	Të miratuara	Të refuzuara	Të pezulluara	Gjithsej
843	-	-	821	4	18	843

KRYERJA E PUNËVE TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Nr.	EMËRTIMI I LLOJIT TË PUNËS	SASIA	SHËNIM
1	Kopje Plani	1803	
2	Konsultime me palë	436	
3	Marrje e produkteve	839	

KRYERJA E PUNËVE PËR TË CILAT ZHVILLOHET PROCEDURË ADMINISTRATIVE

Në tabelën e poshtëshënuar janë paraqitur punët e kryera në formën tabelare, nga të gjitha punët e kryera gjatë vitit **2024**.

Nr.	EMËRTIMI I PUNËS	NR. I LËNDËVE	SHËNIM(vërejtje)
1	Ndarje të parcelave(regjistrim i ndarjeve)	748	në zyrë
2	Punë për shërbimin pronar- juridik	22	në terren
3	Rirregullim kufiri	5	në zyrë

4	Ndërrimi kultures së parcelave	4	në zyrë
5	Regjistrim I ndertesave	15	në zyrë
8	Bashkim i parcelave	22	në zyrë
9	Regjistrimi i pjesëve të ndertesave	5	në terren

Sektori Kadastri

Të dhënat dhe aktivitetet të cilat janë kryer gjatë vitit 2024 janë të prezentuara në formë tabelare.

Nr.	Llojet e kërkesave	Nr. i kërkesave të pranuar gjatë këtij viti	Nr. i kërkesave nga viti i kaluar	Të pezulluara	Të miratuara (kryera)	Të refuzuara	Në procedurë
1	Regjistrim prone	2401	-	-	2206	-	195
2	Regjistrim dhe fshirje të Hipotekave	238	-	-	238	-	-
3	Të tjera, Historiat,modifikim i te dhenave,regjistrim i mase se perkohshme	487	-	-	487	-	-
4	Çertifikata të Pronësisë	5827	-	-	5827	-	-
5	Vërtetime për raste sociale	4035	-	-	44035	-	-
6	Njoftim per palen e interesuar lidhur me te dhenat kadastrale	100		-	100	-	-
7	Gjithsej:	13088		-	12893	-	195

Raporti I lëndëve të regjistruara sipas gjinisë për vitin 2024

Bashkëshortë	Burra	Gra	Persona Juridik
356	1727	192	64

Gjatë vitit 2025 janë paraqitur numër i madhe i kërkesave për tu shqyrtuar. Në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastrë, kemi pranuar dhe shqyrtuar këtë numër të lëndëve **17.098** Sfidues ka qenë edhe këtë vitë numri I vogël i zyrtarëve që kanë ofruar shërbime për qytetar në krahasim me numrin e kërkesave.

Realizimi i objektivave

- 1. Arritja e një transparence më të lartë
- 2. Projekti i Rindërtimit të Kadastrit
- 3. Shpejtimi i Azhurimit të Lëndëve.
- 4. Promovimi i punës dhe fitimi i përkrahjes nga Institucionet dhe Organizatat e ndryshme.

Bashkëpunimet

Gjatë periudhës së vitit 2025 kemi pasur bashkëpunime me institucione dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare; me zyrtarët e Agjensionit kadastral kemi mbajtur takime të rregullta për avancimin e punës profesionale në drejtorat. Gjatë këtij viti kemi mbajtur takime të rregullta edhe me zyrtar të organizatave të ndryshme.

DREJTORATI PËR INFRASTRUKTURË

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave të Drejtoratit për Infrastrukturë gjatë periudhës prej datës 01.01.2024 deri 31.12.2024, DI ka kryer aktivitetet të planifikuara dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara.

Drejtorati për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka pranuar dhe zgjidhur këto kërkesa:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave)				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
201	134	30	26	11

Gjatë kësaj periudhe **Janar – Dhjetor 2025**, Departamenti për Infrastrukturë ka përgaditur dhe proceduar në Departamentin e Prokurimit për të publikuar projektet e planifikuara në kuadër të Departamentit për Infrastrukturë, si dhe ka përgaditur paramasat dhe parallogaritë për projekte të cilat janë në kuadër të Departamenteve tjera.

Përveq projekteve të parapara në buxhetin e Komunës për vitin 2025 Drejtoria për Infrastrukturë gjatë kësaj periudhe ka paraqitur kërkesa në Ministrit përkatëse dhe institucione tjera për projekte me bashkëfinancim siç janë:

- 1. **Ndertimi I rrugë Topliqan-Kojske**
- 2. **Asfaltimi I rrugës Qylagë – Dobraj e Madhe**
- 3. **Ndertimi I rrugës Rubovc – Bablak**
- 4. **Rregullimi i shtigjeve të ecjes në Qytetin e Lipjanit dhe Fshatin Llugaxhi**

Memorandumet

Kryetari i Komunës ka nënshkruar dy Memorandum bashkëfinancimi me MMPHI për projektet:

- 1. **“Ndërtimi I Urës mbi Lumin Sitnica” në vlerë 370.000,00 Euro**
- 2. **“Ndertimi i rrugicave ne fshtrat Sllovi, Gadime, Smallush, Gumnasell, Lluugaxhi dhe Babush”**
- 3. **Fondi per eficiencë të Energjis (FKKE) ne vlerë prej 233.530,00 Euro,**
Ndersa Komuna e Lipjanit do te participoj **23.353,00 Euro**

Ecuria e projekteve

Gjate kësaj periudhe kanë vazhduar punimet në projektet të cilat i kemi lidhur kontratat në vitin 2024, Ndërsa projektet për të cilat kemi lidh kontrat në vitin 2025 kanë përfunduar punimet në projektet te cilat kan qenë nje vjeqare, ndersa ato projekte që jan dy vjeqare do të vazhdojn punimet edhe në vitin 2026.

Lista e projekteve nga Drejtoria për Infrastrukturë

1	Ndertimi I parkut qendror te qytetit dhe Parkingut nentoksor ne Lipjan	Afër përfundimit
2	Ndertimi I rrjetit te kanalizimit dhe asfaltimi I rrugicave ne Kleqk	I përfunuar
3	Aneks te rrjetit te ujesjellsit ne lgjet ne sllovi dhe ne lagjen e Konjihut dhe ne lagjen e Akllapit	I përfunuar
4	Asfaltimi I rrugicave në Magure, Vershevc, Leletiq, Poturovc,Torinë dhe Bujari Faza III	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
5	Asfaltimi I rrugicave në Llugaxhi dhe Dobraj të Madhe Faza III	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
6	Hapja dhe ndertimi I rrugës Pjeter Bogdani deri te rruga Xhevdet Breznica Lipjan	
7	Ndertimi dhe Rikonstruimi I ndriqimit publik në rrugen Sadik Shala, Ganimete Terbeshi, Isa Olluri, Afrim Zhitia në Lipjan	Në Implimentim (Kontrat dy vjeqare)
8	Ndertimi I trotuareve në fshatit Baic	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
9	Ndertimi infrastrukturës së varrezave në fshatin Babushë	I përfunduar
10	Ndertimi I Trotuarit Marevc - Llugaxhi	I përfunduar
11	Ndertimi dhe Rikonstruimi I rruges se shkolles ne Dobraj te Madhe dhe rrugicat tjera	I përfunduar
12	Asfaltimi I rrugicave në lagjet e fshatrave Babush, Gadime faza IV	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
13	Asfaltimi I rrugicave në lagjet e fshatrave Banull Gllavic, Marevc,Qallapek faza III	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
14	Ndertimi I trotuareve në fshatin Kraishtë	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)

15	Ndertimi i Shtëpis Muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir	ka përfunduar faza I
16	Ndriqimi publik ne fshatin Jeta e Re	I përfunduar
17	Asfaltimi i rrugicave ne Lagjen Pojata ne Krojmir	I përfunduar
18	Rikonstruimi i rruges "Poturovc - Ribar I Madh"	I përfunduar
19	Ndertimi i Murit Gabion ne Gadime të Ulet (afer shpelles)	
20	Rikonstruimi i rruges Dobratin - Sllovi	I përfunduar
21	Rikonstruimi i ndriqimit public ne Janjev dhe Gadime te ulet	I përfunduar
22	Ndertimi i ures mbi lumin Sitnica	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
23	Asfaltimi i rrugicave ne Konjuh, Glllogovc, Ribar I Madh	I përfunduar
24	Ndertimi i ures ne Rubovc dhe ne Gomnasell	I përfunduar

Lista e projekteve nga Departamentet tjera e që menaxhohen nga Departamenti për Infrastrukturë

1	Ndertimi i qendres urgjente ne Qytetin e Lipjanit	Afër përfundimi
2	Ndertimi i infrastruktures se jashtme te QKMF-së LIPJAN	Në implimentim
3	Renovimi dhe adaptimi i QKMF-së ekzistuese për nevoja të OJQ-ve (te personave me aftësi të kufizuara) dhe Shoqatave të tjera ne Lipjan	I përfunduar
4	Ndertimi i Qendres multifunkionale ne qytetin e Lipjanit (	Në implimentim (Kontrat tri vjeqare)
5	Furnizimi dhe vendosja me bari sintetik dhe infrastruktura tjeter ne fushat sportive ne Magure dhe Dobraje e Madhe	I përfunduar
6	Ndertimi dhe Riparimi i kulmit në Qerdhe në Lipjan	
7	Rregullimi i infrastruktures ne Oborrin e Qendres Rezedenciale Lipjan	Në implimentim (Kontrat dy vjeqare)
8	Rregullimi i infrastruktures ne oborrin e shkolles ne Ribar te Madh	I përfunduar

Tabelat pëmbledhëse te projekteve me statistika

	Asfaltimrt ne metra ¹		Asfaltimet ne metra 2		Sinjalizim m ¹
Kleqk	1,500.00		4,500.00		
Glllogovc	1,200.00		3,600.00		
Konjuh	1,200.00		3,600.00		
Gumansell	2,750.00		8,250.00		
Verrshevc	2,500.00		7,500.00	(Vetëm të zhavoruara)	
Llugagji	3,300.00		9,900.00		
Gadime e Ulët	2,500.00		7,500.00	(Vetëm të zhavoruara)	
Gadime e Epër	1,750.00		5,250.00	(Vetëm të zhavoruara)	
Banull	1,750.00		5,250.00	(Vetëm të zhavoruara)	
Krojmir (pojata)	1,200.00		3,600.00		
Ribar I Madh	700.00		2,100.00		
Asfaltimi i rruges - Dobratin - Sllovi	2,400.00		14,400.00		2,400.00
asfaltimi i rruge - Ribar I madh Poturovc	2,850.00		14,250.00		2,850.00
Asfaltimi i rruges se shkolles ne Dobraj te madhe	735.00		4,042.50		735.00
Totali	26,335.00		93,742.50		5,985.00

	Trotuar metrat ¹		Trotuar metrat 2	Shtegu i bicikletave
Lugaxhi - Marevc	1,200.00		1,440.00	
Ndertimi i trotuarit ne Dobraj te madhe rruga e shkolles	735.00		1,837.50	735.00
Trotuari Kraisht	1,360.00		1,632.00	
Trotuari Dobratin - Sllovi	2,000.00		1,700.00	
Trotuari në Bains	1,750.00		2,100.00	
Totali	7,045.00		8,709.50	

	Ndriqimi publik m ¹
Ndriqimi publik ne Dobraj Rruga e shkolles	735.00

Ndriqimi publik ne rrugen Sadik Shala ne Lipjan	1,300.00
Ndriqimi publik ne rrugen Afrim Zhitia ne Lipjan	350.00
Ndriqimi publik ne Jnajeve	3,500.00
Ndriqimi publik ne Gadime te ulet	1,000.00
Ndriqimi publik Jeta e re	1,700.00
Totali	8,585.00

	Kanalizim fekal		
Kanalizimi ne Kleqk	735.00		
Gadim e Ulet	250.00		
Totali	985.00		
	Ujesjells		
ujesjells ne Lipjan (lagjja e akllapit)	1,425.00		

	Urat		
Ndertimi I ures mbi lumin sitnica (ne proces)			
Ndertimi I ures ne Gumnasell			
Ndertimi I ures ne Rubovc			

Projekte të tjera
Ndertimi infrastrukturës së varrezave në fshatin Babushë
Rregullimi I infrastruktures ne oborrin e shkolles ne Ribar te Madh
Ndertimi I Stadiumit ne Magure
Ndertimi I stadiumit ne Dobraj te madhe
Ndertimi I Shtëpis Muze të veteraneve të UÇK-së Krojmir (ne proces)
Ndertimi I Qendres multifunkionale ne qytetin e Lipjanit
Ndertimi I qendres urgjente ne Qytetin e Lipjanit (ne proces)
Ndertimi I infrastruktures se jashtme te QKMF-së LIPJAN (ne proces)

Sektori i menaxhimit të projekteve përveq bashkëpunimit në detyrat projektuese, hartimin e projekteve, hartimit të paramasave dhe parallogarive, procedimit të lëndëve në procedura të publikimit, menaxhimit të projekteve në teren dhe pranimit përfundimtar të punimeve, ka kryer edhe punë të tjera në suaza të kompetencave në bashkëpunim edhe me departamentet tjera.

Në kuadër të aktiviteteve të departamentit, veçojmë angazhimin në kuadër të grupit të performancës, në komisione për vlerësimin e dëmeve, në komision për vlerësimin e tenderëve, në hartimin e rregulloreve dhe strategjive, etj.

Departamenti infrastrukturës ka ndërtuar sistemin elektronik të të dhënave të infrastrukturës në territorin e komunës tonë të cilat të dhëna përditësohen, vërsishte nga zhvillimi i ndërtimit të Infrastrukturës në teren.

DREJTORATI PËR INSPEKSION

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Drejtorati i inspektoratit për gjatë vitit 2025 me prioritet ka realizuar agjendën e planifikuar duke vepruar përputhshmërisht me ligjet, udhëzimet administrative si dhe rregulloret komunale.

Janë realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Për realizimin e punëve në drejtori dhe objektivave të synuara janë realizuar inspektime të planifikuara, pa planifikuara , ad-hoc, inspektime të përbashkëta, si dhe inspektimet e bazuara në kërkesat dhe ankesat e qytetarëve.

Me qëllim të përmbushjes së detyrave dhe përgjegjësisë janë organizuar kujdestari të shumta, në ndërrimin e pasdites, vikendeve dhe festave zyrtare për të ju përgjigjur ankesave dhe parregullsive të paraqitura. Gjithashtu, janë realizuar inspektime të ndryshme në bashkëpunimin me Policin e Kosovës-Stacioni Policor-Lipjan.

Si inspektorat kemi ofruar bashkëpunim me drejtoritë tjera në nivel komunal, me organet gjyqësore, Policinë e Kosovës, institucione të tjera, si dhe bashkëpunim me qytetarët.

Inspektoret e Tregut- Inspektorët e Tregut veprojnë në kuadër të inspektoratit si organ ekzekutiv me përgjegjësi dhe autorizime të veçanta, bëjnë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve të parapara për mbarëvajtjen e veprimtarisë së bizneseve. Këtë mbikëqyrje e ushtrojnë në bazë të Ligjit për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut Nr.03/L-181 të datës 22 korrik 2010, dhe plotësim ndryshimin e Ligjit mbi Inspektoratin e Tregut Nr. 04/L-186 të datës 29.04.2013.

Inspektoret e Tregut, gjatë vitit 2025 kanë zhvilluar inspektime të bazuara në Planin e Punës për vitin 2025. Qëllim kryesor i sektorit të tregut është që të punojë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret komunale, në mënyrë që të ndihmojë bizneset, organizatat dhe konsumatorët, parandalimin e ekonomisë joformale, sigurinë e përgjithshme të produkteve të plasuara në treg, si dhe mbrojtjen e konsumatorit. Inspektoret e Tregut kanë për detyrë të sigurojnë përputhshmërinë e produkteve në treg gjegjësisht sigurinë e produkteve me ligjet në fuqi.

Rëndësi e veçantë i është kushtuar subjekteve ekonomike të cilët nuk kanë qenë të regjistruar në ARBK, pa pranimë teknike të lokaleve afariste për plotësimin e kushteve tekniko higjieno sanitare, vendosjen e flamujve afër produkteve se nga është origjina e atyre produkteve, po ashtu është bërë kontrollimin e subjekteve afariste për cilësinë e mallit përkatësisht afatin vlefshmërinë e mallit kushtet e ruajtjes së mallit, dhënien e faturave për shërbimet e ofruara konsumatorëve në (formë elektronike apo të shkruara), prejardhjen e mallit, librat e punës, krahasimin e çmimeve të ekspozuara me ato të arkës, vendosjen e çmimeve nëpër artikujt të ekspozuara, çertifikatat e kalibrimit të njësive matëse pran organit të licencuar për kalibrim, respektimin e orari të punës, kontrollimin e licencave për operatorët të cilët merren me tregtimin e karburanteve dhe lubrifikanteve dhe çertifikatën e cilësisë së tyre. Po ashtu janë inspektuar lokalet afariste si restorantet, kafiterit, maketet ushqimore dhe biznese të tjera për respektimin e ligjit të duhanit etj. Janë ndëshkuar edhe subjektet ekonomike të cilët nuk e kanë respektuar vendimet e inspektoratit.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Nga sektori i mjedisit për mbrojtjen e ambientit është punuar sipas planit inspektues për vitin 2025.

Në planin inspektues është paraparë:

- Pranimi i ankesave të qytetarëve dhe shqyrtimi i tyre në teren në fushën e mbrojtjes së mjedisit. Kontrolli të shpeshta në deponit ilegale të mbeturinave, ndëshkimi me gjoba mandatorë, fletëparaqitje në gjykatë, ndaj të gjithë atyre që hasen, gjinden dëshmi apo lajmërohen rastet nga qytetarët për ndotjen e hapësirës publike, natyrës etj.

- Mbikëqyrjen e menagjimit të mbeturinave në Komunën e Lipjanit nga operatori i pajisur me leje mjedisore respektivisht mbikëqyrjen e grumbullimit, transportimit të mbeturinave nga ekonomitë familjare, nga bizneset si dhe transportimit të tyre deri në deponin regjionale.

- Mbrojtjen e ujërave, tokës, ajrit nga ndotja, mbikëqyrjen e kushteve të lejeve mjedisore komunale të aprovuara nga drejtoria e përkatëse, mbrojtjen nga zhurmat eventuale, si dhe kontrolla tjera që kanë të bëjnë me ruajtjen e hapësirave publike, ruajtjen e ambientit nga ndotja sipas ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve komunale.

Gjatë vitit 2025 janë shqyrtuar kërkesa dhe ankesa të qytetarëve janë bërë inspektime në vendngjarje për secilin rast, e që kërkesat kryesisht kishin të bëjnë me ndotjen e mjedisit me mbeturina komunale, mbeturina nga ndërtim demolimi-inerte të hedhura në hapësirat publike, private, ndotjet e ajrit si pasojë e ndezjeve të mbeturinave, ndotja e ajrit nga guroret, pastaj ndotja e ajrit gjatë ndërtimit në vendpunishte, problemet me ujëra të zeza si pasojë e mbylljeve të rrjetit të kanalizimit pastaj probleme me mbylljen e kanaleve për ujërat atmosferik etj.

Për çdo ankesë është konstatuar gjendja me procesverbal, aty ku janë gjetur parregullsi janë dhënë urdhëresa, vërejtje për sanimin e parregullsive varësisht nga gjendja në teren. Janë shqiptuar gjoba mandatore ndaj personave fizik apo subjekteve që janë takuar apo janë gjetur dëshmi për ndotjen e mjedisit me mbeturina. Ankesat e pranuar nga qytetarët për mbyllje të rrjetit të kanalizimit janë adresuar tek ujësjellësi, janë dhënë urdhëresa operatorit për sanimin e problemit të rrjetit të kanalizimit sipas ankesave.

Është bërë kontrolli tek objektet që janë në ndërtim me shumë njësi banimi dhe afarizëm, depo, objekte tjera afariste të cilat janë në ndërtim apo biznese që zhvillojnë aktiviteti në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale të aprovuara nga DPUMM. Janë dhënë urdhëresa për pastrim të rrugëve nga balta, pastaj grumbullim të mbeturinave në vendpunishte, vendosja e tyre në kontejner, dorëzimin e tyre operatorit që menaxhon me mbeturina në komunën tonë dhënë urdhëresa mos të krijohet pluhur për zbatimin e kushteve të LMK-së gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre. Ndaj disa bizneseve janë shqiptuar edhe gjoba me aktvendim për mos zbatim të kushteve të lejes mjedisore komunale.

Sipas rregullores komunale të gjitha bizneset (restorantet, kafiterit, baret etj) të cilët kanë shfrytëzuar hapësirën publike qoftë mallra të ekspozuara apo me tavolina dhe ulëse, janë detyruar dhe janë pajisur me pëlqim për hapësirën në shfrytëzim nga drejtoria përkatëse e Komunës.

Si përfundim mund të themi se gjendja e ambientit në përgjithësi nuk është në nivelin e kënaqshëm, ambienti ende po vazhdohet të ndotet nga biznese dhe qytetarë e sidomos me mbeturina inerte (nga ndërtim-demolimi) sepse nuk ka ende kompani për

menaxhim këtij lloji të mbeturinave në Komunën tonë. Mirëpo, ambienti është duke u përmirësuar gradualisht falë rritjes së ndërgjegjësimit të qytetareve për ruajtjen e ambientit, investimeve nga Komuna e Lipjanit duke i pajisur të gjitha ekonomitë familjare me shporta për mbeturina, si dhe largimin e disa deponive ilegale.

Inspektoret e trafikut- Përgjatë këtij viti, puna e inspektoreve të trafikut është realizuar në përputhje me planin dinamik të punës. Objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal. Gjatë këtij viti janë organizuar aksione të shumta në bashkëpunim me Policinë e Kosovës njësisia në Lipjan si dhe me Policinë Kufitare në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari”, ku është bërë inspektimi i radio-taksive që marrin pasagjer pa porosi dhe auto-taksit ilegal, po ashtu janë inspektuar disa kompani të radio-taksit të cilët kishin licencë dhe merrnin udhëtar vetëm me porosi, si dhe rentat. Ata të cilët janë takuar duke bërë shkelje janë marrur masa ligjore, Gjatë vitit janë inspektuar firma të autobusëve, auto taksit, radio taksit; firmat e autobusëve janë inspektuar për rende të udhëtimit se a janë duke e respektuar rendin e udhëtimit ku disa prej tyre i janë dhënë vërejtje që t’i respektojnë në vazhdimësi, ndërsa për radio-taksi dhe auto taksi janë kontrolluar për licencë. Kontrollimi i vazhdueshëm i trotuareve në qytet, disa lokale janë urdhëruar me procesverbal që trotuari gjithmonë të jetë i lirë për këmbësorët dhe mos të vendosen reklama, janë kontrolluar edhe rrugët në qytet dhe fshatra ku janë vendosur pengesa në rrugë pa pëlqim nga organi kompetent ku janë urdhëruar që të largohen menjëherë nga rruga. Inspektimi i firmave kontraktuese të KEDS-it, ujësjellësi dhe të tjera të cilat zhvillonin punime për vendosjen e rrjetit elektrik, rrjeti i kanalizimit dhe rrjeti i ujësjellësit se a janë pajisur me pëlqim për ata të cilët nuk ishin të pajisur janë urdhëruar me procesverbal që ti ndërprerjen punimet deri sa të pajiseni me dokumentacion që ju lejohet prerja e asfaltit dhe trotuarit.

Inspektori i ndërtimit- Gjatë vitit 2025 Inspektori i ndërtimitarisë ka inspektuar objekte të ndryshme ndërtimi në të gjitha zonat e ndërtimit dhe zonat tjera ndërtimore, duke përfshirë edhe periferinë e qytetit. Gjendja e ndërtimit për gjatë gjithë vitit ka qenë nën kontrollin e vazhdueshëm inspektues. Janë identifikuar një numër i vogël i objekteve pa Leje ndërtimi në zonat e ndërtimit, ndaj të cilave janë ndërmarrë masa ligjore konform Ligjit të Ndërtimit e dispozitave ligjore në fuqi. Të gjitha Inspektimet e realizuara rezultojnë të pajisura me leje ndërtimi nga organi kompetent. E arritura e Inspektionit të ndërtimitarisë gjatë vitit 2025, është se ka filluar Rrënimi i objekteve me Leje rrënimi për objektet ekzistuese-Amortizuara dhe objekteve shtëpi-banimi, gjithashtu janë inspektuar edhe objektet-projektet e Investuara nga Komuna. Inspektori i Ndërtimit ka pasur bashkëpunimi të kordinuar me Policinë duke i njoftu për secilin ndërtim të filluar pa Leje, duke përfshirë edhe njoftimet e fillimit të ndërtimeve, kërkesave për inspektim nga Investitorët, kërkesave për Raporte Finale e Çertifikatat e Përdorimi për objektet e përfunduara-finalizuara nga Investitorët, si dhe një vetëdijesim i shtuar i Investitorëve për ndërtime konform rregullave e procedurave ligjore, gjë e cila vërehet nga viti në vit për një numër më të vogël të ndërtimeve pa leje, duke përfshi edhe shqiptimin e gjobave mandatore ndaj ndërtuesve, kallëzime penale e fletëparaqitje ndërtimi pa leje gjë e cila ka ndikuar dukshëm në përmirësimin e gjendje në fushën e ndërtimeve pa leje.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2025:

Janë inspektuar lokalet afariste, si: marketet, barnatoret humane, mishtoret, furrat e bukës, mullinjtë e grurit, auto-sallonet e veturave dhe veprimtari të tjera ekonomike ku janë kontrolluar çmimet e artikujve ushqimor në rafta dhe çmimet e arkës gjatë pagesës.

Janë realizuar urdhëresa për pranime teknike të lokaleve afariste., si dhe janë bërë 137 pranime teknike të lokaleve afariste.

Inspektim i marketeve lidhur me zbatimin e Ligjit 06/L034 për Mbrojtje të Konsumatorit.

Inspektimi i bizneseve të cilat merren me shitjen e auto-pjesëve.

Inspektimi i bizneseve dhe marketeve të cilat mirren me shitjen e duhanit dhe alkoolit në lidhje me zbatimin e Ligjit nr.06/L034 për Mbrojtjen e Konsumatorit.

Urdhëresa me procesverbal për deklarimin e çmimit të produkteve në raft dhe vendosjen e flamujve-tregues të origjinës.

Largimi i shitësve ambulant pa pëlqim nga Sheshi “Adem Jashari” dhe rrugët e qytetit.

Ndalimi i tregimit në rrugët e qytetit (ndalim i shitjes jashtë tregut).

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Inspektim për lejet për rrënim.

Inspektimi i auto-taksive lokale, si dhe auto-taksitë që operojnë në ANP-Adem Jashari.

Ndalesa të vazhdueshme dhe ndëshkim për taksistët ilegal.

Inspektimi i radio- auto-taksive në qytetin e Lipjanit.

Inspektimi-kontrollimi i operatorëve-autobusëve në qytet dhe fshatrat për rendet e udhëtimit.
Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.
Inspektim i firmave ndërtimore të cilat e dëmtojnë pjesën e trotuarit gjatë hyrje-daljes nga punishtja me kamion.
Urdhëresa për kryerje të obligimit të pagesës për bizneset ndaj Komunës për shfrytëzimin e hapësirave publike (terasave) sipas rregullores komunale.
Identifikimi i ndotësve përmes dëshmime të gjetura në teren, informatave të pranuar nga qytetarë dhe shqiptimi i gjobave.
Kontroll investitorëve të objekteve ndërtimore me shumë njësi banimi dhe subjektet tjera në zbatimin e kushteve të Lejes Mjedisore Komunale.
Pëlqimet për hapësirat publike, nga bizneset në qytet.
Shqiptimi i gjobave ndaj ndotësve të mjedisit.
Fletëparaqitje për Kundërvajtje
Shqiptimi i gjobave mandatore.
Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspektime	Inspektime me procesverbal	Kërkesa te shqyrtuara për pranime teknike	Gjopa për mos zbatim të kushteve të LMK-së	Fletëparaqitje	Kallëzim penal	Kontrolla për LMK	Të pa inspektuara LMK për vitin 2025	Vërejtje, njoftime	Vendosja të shiritave zyrtar	Refuzime për kushte ndërtimore	Objekte me leje qe nuk e kanë filluar ndërtimin	Punë me palë, ankesa , kërkesa	Lendet e pranuar dhe te shqyrtuara	Lende te pezulluara, ekzekutuara gjygesore	Gjopa mandatore	Ndërtesa te reja te inspektuara me leje dertimi	Njoftime për fillimin e ndërtimit	Te hyra nga pranime teknike	Objekte te reja te pajisura me leje ndërtimore	Objektet te legalizuara	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspektim me polici	Inspektim I bizneseve pa regjistrim pa pranim teknik	Inspektim për LMK të vitit 2024	Konfiskim i targave dhe librezës dhe kthimi i tyre	Ndërtesa të inspektuara nga viti paraprak me leje ndërtimi
Biznesi	1682	275	124		15								701	154	5				1900€			163	167	36	42			
Ambient	397	105		2			41	5	11				85	73	2	6							26	15		26		
Ndërtimi	721	176			1	2				16	60	30	36	179	2	10	46	26		76	33		8					20

